Në Komunën e Deçanit janë 20 shkolla (24 objekte shkollorë ku zhvillohet mësim)

Shkolla të mesme të larta janë 2

- Gjimnazi “Vëllezërit Frashëri” nxënës të regjistruar klasa e 10 ka 170 nxënës, rreth 466 nxënës gjithsej.
- IAAP “Tafil Kasumaj” të regjistruar në klasën e 10 janë 190 nxënës, rreth 500 nxënës gjithsej.

Ne IAAP “Tafil Kasumaj”, ka rritje të ndjeshme të nxënësve në dy vitet e fundit.

Ndërsa në Shkollat Filllore dhe te Mesme te Ulëta, nxënës të regjistruar në fillim vit janë Klasa Prafillor janë rreth 350 fëmijë

Niveli 1 - 5 janë rreth 1860 nxënës

Niveli 6 – 9 janë rreth 1580 nxënës

Gjithsej 3790 nxënës, këtë vit rreth 50 nxënës me pak të regjistruar se në vitin e kaluar, Braktisje të shkollimit nga nxënësit nuk ka viteve të fundit.

Shpërngulje në botën e jashtme vitin shkollor 2023/2024 janë rreth 12 fëmijë dhe 3 mësimdhënës.

Jemi në përfundim të PZHAK,

Vëmendje: Numri i nxënësve nuk është përfundimtar, sepse ende nuk ka përfunduar regjistrimi në klasat Parafillorë, klasat e para dhe klasat e 10.

Përgatitjet e objekteve shkollorë për fillimin e vitit shkollor janë bere me kohë, fillimisht janë dezinfektuar të gjitha objektet shkollorë nga stafi Teknik i shkollave i trajnuar posaçërisht për këtë punë nga koha e pandemisë,

Shkollat janë furnizuar me materiale higjienike dhe didaktike me kërkesat e shkollave sipas nevojave të tyre,

Ndërsa pajisja e nxënësve me tekste shkollorë qe dy vite është problem forma e subvencionimit të prindërve me të holla, sepse ekzekutimi i mjeteve ka probleme edhe të pa shpjegueshme,

Ketë muaji do të fillon furnizimi i shkollave me dru dhe pelet për ngrohje.

Është e ditur edhe ndërprerja e ndërtimit të shkollës së qytetit, vonesat ne ndërtimin e shkollës në Ratishë, dhe ne shkollën e Lumbardhit,

Ndërtimi i Çerdhës së qytetit është duke vazhduar, gjithashtu jemi në pritje implementimi i ndërtimit dhe adaptimit edhe të 4 çerdheve tjera.

Nga projekti i Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave për digjitalizim të shkollave vitin që 2024 kane përfituar 7 shkolla te komunës sonë, përkundër premtimeve se të gjitha shkollat do të përfitojnë nga ky projekt, jemi në pritje që edhe shkollat të implementohet projekti.

Deçan, dt.17.09.2024



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DEÇANIT
MUNICIPALITY OF DEÇAN
OPSTINA DEÇAN



KOMUNA E DEÇANIT

**DRAFT- STRATEGJIA KOMUNALE PËR MBROJTJE NGA DHUNA NË
FAMILJE (2024 – 2027)**

DHE

**PLANI I VEPRIMIT PËR MBROJTJE NGA DHUNA NË FAMILJE
(2024 – 2027)**

Shtator, 2024

Lajmërimi i rasteve të dhunës në familje

Kontaktet:



Numri pa pagesë 080019999 -Policia e Kosovës
039 421-398 Shtëpia e Sigurt
0390 361 014– Qendra për Punë Sociale
192 - Thirrjet emergjente

PËRMBAJTJA

Kapitulli I:	HYRJE PËRMBLEDHËSE
Kapitulli II:	QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT STRATEGJIKE TË STRATEGJISË
Kapitulli III:	ANALIZA E SITUATËS DHE PROBLEMATIKA E DHUNËS NË FAMILJE
Kapitulli IV:	KOHËZGJATJA E ZBATIMIT TË STRATEGJISË DHE INSTITUCIONET E PËRFSHIRA
Kapitulli V:	AKTIVITETET NË ZBATIM TË STRATEGJISË
Kapitulli VI:	PLANI I MONITORIMIT DHE I VLERËSIMIT TË PROGRESIT NË ZBATIM
SHTOJCA 1:	PLANI I VEPRIMIT

LISTË ME SHKURTESA DHE EMRI I PLOTË I INSTITUCIONEVE:

QPS - QENDRA PËR PUNË SOCIALE

AMU – ARSIMI I MESËM I ULËT

AML – ARSIMI I MESËM I LARTË

KKSB - KËSHILLI KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI

ZBGJ- ZYRA PËR BARAZI GJINORE

FALËNDERIME

Draft-Strategjia Komunale kundër Dhunës në Familje (2024 – 2027), është një prej dokumenteve të rëndësishme të Komunës së Deçanit, hartimi i së cilës ka ndjekur një proces të mbledhjes së dhënave nga institucionet relevante që punojnë në këtë fushë. Përfshirja dhe kontributi i tyre kanë dhënë frytin e punës që gjendet në faqet e këtij dokumenti të rëndësishëm për parandalimin e dhunës në familje në komunën tonë.

Grupi i punës për hartimin e Strategjisë dhe Plani i Veprimit, drejtoritë si dhe Mekanizmin Koordinues kundër Dhunës në Familje.

Bazuar në Ligjin Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), bazuar në Ligjin Nr.08/L-185 për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në Baza Gjimore, në Strategjinë Kombëtare për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave 2022-2026 dhe Udhëzimit Administrativ (QRK) Nr.07/2018 për planifikimin dhe Hartimin e Dokumenteve Strategjike dhe Planeve të Veprimit.

KAPITULLI I

HYRJE PËRMBLEDHËSE

Hartimi dhe zbatimi i Strategjisë Komunale dhe Planit të Veprimit kundër Dhunës në Familje për Komunën e Deçanit, mundëson koordinimin e përpjekjeve ekzistuese të qeverisë komunale dhe të organizatave joqeveritare. Qëllimi i vetëm i këtyre përpjekjeve të përbashkëta është të parandalojë dhe luftojë Dhunën në Familje si dhe të ndihmojë zhvillimin adekuat dhe mirëqenien e gjithë shoqërisë sonë.

Parandalimi dhe luftimi i Dhunës në Familje kërkon angazhim të strukturave të ndryshme publike dhe private, për të diskutuar dhe zgjidhur çështjet të ndryshme si ato të arsimit, shëndetit, shërbimeve sociale, punësimit, drejtësisë, familjes, fëmijëve dhe të moshuarve, etj. Tërë këto çështje përmbajnë problematika që duhen zgjidhur përmes proceseve të zhvillimit të shoqërisë në tërësi. Strukturat vendimmarrëse, së bashku me organizatat joqeveritare, kanë detyrime në zbatim të kësaj strategjie, të cilat rrjedhin nga funksionet specifike dhe roli që luajnë në shoqëri.

Ky dokument synon të japë ndihmesën e saj në arritjen e standardeve më të larta në trajtimin e çështjeve të Dhunës në Familje, si pjesë e përpjekjeve të Komunës së Deçanit.

Kjo strategji i referohet implementimit si dhe zbatimit të kuadrit ligjor kundër dhunës në familje në tërësi, i cili ndër të tjera thekson:

1. Të hartohen politika në nivel lokal për parandalimin, mbrojtjen dhe ofrimin e shërbimeve për viktimat dhe ushtruesit e dhunës në familje;
2. Mbështetja financiare e strehimores që mbështetin nëna me fëmijë, në proporcion me numrin e rasteve nga Komuna e Deçanit të strehuara si viktima të dhunës në familje.

Hartimi i kësaj strategjie është kryer përmes një procesi të gjatë pjesëmarrës nën drejtimin e Komunës, drejtuesit më të lartë dhe stafet përgjegjëse të drejtorive të ndryshme përfshirë në proces, së bashku me të gjitha institucionet e tjera në nivel komunal. Gjatë muajit nëntor, më 25 nëntor fillon fushata “16 Ditët e Aktivizimit” dhe do të organizohen një sërë takimesh të gjëra për njohjen e situatës, hartimin e drejtimeve strategjike dhe planifikimin e aktiviteteve specifike sipas termave kohorë të kësaj strategjie.

KAPITULLI II

QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT STRATEGJIKE TË STRATEGJISË KOMUNALE KUNDËR DHUNËS NË FAMILJE

Krahas vështirësive ekonomike, shoqëria jonë po ballafaqohet edhe me një sërë problemesh tjera të papunësisë, të lëvizjeve demografike, të koncepteve të ndryshme mbi vlerat dhe virtytet njerëzore, të cilat ndikojnë drejtpërsëdrejti në pjesëmarrjen e ulët të gruas në vendimmarrje dhe pabarazisë gjinore. Prandaj, Komuna jonë ka nevojë që të hartojmë këtë strategji me anë të së cilës synojmë një shoqëri ku secili respektohet si duhet dhe të jetë në gjendje të realizojë potencialin që ka, pa dhunë dhe diskriminim.

Strategjia komunale kundër Dhunës në Familje për Komunën e Deçanit, synon të:

- Të punojë në parandalimin e dhunës në familje dhe ngritjen e vetëdijes tek komuniteti për aspektet negative të këtij fenomeni;
- Të përmirësojë/ndërtojë sistemin e grumbullimit dhe shkëmbimit të të dhënave në mes të akterëve relevantë;
- Të fuqizojë mekanizmat për reagim sa më të shpejtë ndaj rasteve të dhunës në familje dhe të përmirësojë koordinimin në mes anëtarëve të grupit gjatë menaxhimit të tyre;
- Të bëjë avokim dhe monitorim të zbatimit të politikave si dhe të sugjerojë ndryshime bazuar në përvojat më të mira nga terreni.

Fushat e veprimit dhe objektivat strategjike të këtij dokumenti janë:

Fushat e Veprimit A.

ELIMINIMI I PABARAZIVE GJINORE DHE DHUNËS NË FAMILJE

Deri në vitin 2027, strategjia komunale synon që të kontribuojë në ndryshimin e qasjes në familje dhe shoqërisë për eliminimin e pabarazisë gjinore dhe dhunën në familje

Fushat e Veprimit B.

ARSIMIMI DHE INFORMIMI

Deri në vitin 2027, strategjia komunale synon një komunitet të mirë informuar, edukuar në çështjet e dhunës në familje, me profesionistë, të aftë dhe të përgatitur për trajnimin adekuat të viktimave të dhunës në familje dhe të komunitetit në përgjithësi.

Fushat e Veprimit C.

FUQIZIMI I BAZËS EKONOMIKE

Deri në vitin 2027, strategjia komunale synon në parandalimin, mbrojtjen dhe riintegrimin përmes mbështetjes ekonomike dhe dhënien e mundësive për mirëqenien e të mbijetuarave të Dhunës në Familje dhe të familjeve të tyre.

Fushat e Veprimit D.

FUQIZIMI DHE BASHKËPUNIMI NDËRINSTITUCIONAL

Deri në vitin 2027, strategjia komunale synon të ketë një koordinim më të mirë për parandalimin, mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje dhe riintegrimin e tyre dhe të familjeve në jetën ekonomike dhe sociale të komunës.

Çdo objektiv strategjik është zbrëthyer më tej në disa objektiva specifike, për të cilat është zhvilluar një plan veprimi i detajuar me aktivitete, institucionet përgjegjëse dhe partnere si dhe vlerësime të tjera që lidhen me afatet kohore të zbatimit, kostot dhe planin e monitorimit.

KAPITULLI III

ANALIZA E SITUATËS DHE PROBLEMATIKA E DHUNËS NË FAMILJE

Dhuna në Familje nuk është një dukuri e re për qytetarët e komunës sonë, por edhe shoqërinë kosovare në përgjithësi. E shprehur në forma dhe intensitete të ndryshme ajo është trashëguar prej së shkuarës, por në ditët e sotme vërehen edhe shumë tipare të reja të shprehjes së saj. Analiza e shkurtër e situatës në Komunën e Deçanit ka ndihmuar të qartësohet lista e problemeve dhe shkaqeve që i shkaktojnë ato.

Shkaqet që çojnë në rritjen e shkallës së Dhunës në Familje janë të shumta, ndërmjet të cilave përmendim:

Pabarazitë gjinore: Në Kosovë, roli i femrave në proceset e zhvillimit shoqëror, ekonomik dhe politik, është shumë i rëndësishëm, ndonëse ende në ditët e sotme ndeshemi me pabarazi gjinore të dukshme apo të fshehura. Pozita e pabarabartë gjinore ndikohet nga shkalla e ulët e punësimit të grave, vështirësitë që kanë në qasje të shërbimeve shëndetësore, niveli i ulët i integritetit të grave në ekonomi dhe numri i vogël i grave në pozitat udhëheqëse në administratën publike.

Në Kosovë është krijuar një bazë e mirë ligjore sa i përket çështjes së barazisë gjinore dhe janë bërë hapa të dukshme në avancimin e pozitës së grave, ku Komuna e Deçanit krahas viteve të mëhershme, ka shënuar progres të dukshëm në avancimin e gruas. Të dhënat paraqesin një përfshirje më të madhe të grave në politikë, në arsim, shëndetësi e sektorë të tjerë. Megjithatë, ende nuk është arritur përfaqësimi i kënaqshëm gjinor, i paraparë në Ligjin për Barazi Gjinore, në të cilin përcaktohet se pjesëmarrja e barabartë e femrave dhe meshkujve, në institucione apo në nivel të pushtetit, është 50% me 50%.

Duke pasur parasysh trendet e varfërisë, shkallës së papunësisë, për një pjesë të popullsisë në Komunën e Deçanit, femra mbetet në pozitë më të pafavorshme krahasuar me meshkujt si në lëmin e punësimit, nivelit të varfërisë, arsimit, si dhe pjesëmarrjen aktive në sferën publike dhe private.

Pabarazitë gjinore në gjendjen ekonomike: Në Komunën e Deçanit, ashtu si në tërë vendin, gjendja e vështirë ekonomike rëndon më shumë mbi femrat, të cilat kanë numrin më të madh të papunësuarve dhe nivelin më të ulët arsimor. Për vitin 2023, janë të regjistruara numri i përgjithshëm i të punësuarve në Institucionet Komunale¹, është 123 nëpunës i shërbimit civil, 13- nëpunës i shërbimit publik dhe 5- nëpunës administrative dhe mbështetës. Nga kjo shifër vetëm femra janë 33- nëpunëse shërbimit publik dhe 4 – janë nëpunëse e shërbimit publik, duke përfshirë edhe Komunitete jo shumicë që kanë shifrën 3 të punësuarve, nga kjo shifër 1 është femër e komunitetit serb dhe 2 meshkuj të komunitetit boshnjakë, kurse përfitues të skemës sociale kemi një shifër prej 315 familje me 1220 anëtarë, nga kjo shifër 585 janë femra, prej tyre 73 janë nëna vetushqyese dhe 635 bartës të lëndëve janë meshkuj². Kjo tregon se gjendja ekonomiko sociale nuk është në nivel të kënaqshëm.

Probleme sociale të lidhura me dhunën në familje: Martesat e hershme janë një ndër dukuritë evidente po sa i përket në komunën e Deçanit kjo dukuri nuk është shumë e pranishme. Martesat e hershme privojnë të rinjtë, e sidomos vajzat nga arsimimi dhe zhvillimi i perspektivave afatgjata. Vajzat lindin fëmijë në moshën e tyre më të hershme, mbeten të izoluara nga shoqet, shokët dhe familja e tyre. Gratë e reja nuk mund të dalin vetëm, pa pajtimin e burrit apo anëtarëve tjerë të familjes dhe nuk fitojnë të ardhura, po ashtu si shkaktar ekonomik është edhe ndarja jo e barabartë nga trashëgimia familjare, pikërisht kemi cenim ndaj të drejtave të njeriut dhe diskriminim gjinor duke i trashëguar paragjykimet dhe stereotipet, ndaj mbeten të varura ekonomikisht dhe nuk janë vendimmarrëse në ekonominë familjare. Për këto arsye, këto gra të reja janë më të prekura nga dhuna në familje. Sipas disa të dhënave, numri i rasteve të paraqitura në Qendrën për Punë Sociale (QPS) – Deçan, për dhënien e pëlqimit për martesë të hershme ndryshon:

Viti 2021: vetëm 1 rast të martesës së parakohshme

Viti 2022: 2 raste të martesës së parakohshme

Viti 2023: 2 rast të martesës së parakohshme³

Numri i rasteve mund të jetë i pranishëm, por për shumë prej tyre nuk ka raportime.

Dhuna në Familje sjell shumë pasoja në komunitet, të cilat kanë një numër të madh efektesh të padëshiruara:

Kriza familjare: Avancimi i rolit të femrës në shoqëri dhe pozita e saj në familje ka ndryshuar në kuptimin e pavarësimit më të madh të saj, marrjes së iniciativave, edukimit dhe arsimimit, fakte të cilat kanë ndikuar në ndryshimin e roleve në familje dhe shoqëri. Kriza familjare në periudhën e pasluftës në Kosovë ka shkaqe të ndryshme: lëvizja e popullatës nga fshatrat në qytete, kalimi nga familjet e zgjeruara dhe të mëdha në familje më të vogla. Të tilla ndryshime

¹ Zyra e Udhëheqësit të Personelit

² Qendra për Punë Sociale - Deçan

³ Qendra për Punë Sociale- Deçan

shihen si faktorë mbrojtës (kur shmanget ndikimi patriarkal prej brezave më të vjetër), por edhe faktorë rreziku njëherësh, si pamundësia e mbrojtjes në rastet e dhunës në familje të nxitura nga papunësia, konfliktet dhe mentalitetit mes gjeneratave, etj.

RRITJA E DIVORCEVE NË SHOQËRI: Numri i divorceve ndryshon nga viti në vit. Në vitin 2021 ka pasur 32 divorce, në vitin 2022 kanë qenë 40 divorce, ndërsa në vitin 2023 janë 49 divorce. Sa i përket rritjes së numrit të divorceve nga viti në vit, siç po shihet nga dhënat duke u bazuar në Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Pejë - Dega në Deçan kemi rritje⁴. Nga tregues statistikor, numri i rasteve të dhunës në familje të raportuara në Shtëpinë e Sigurt edhe pse kjo Shtëpi e Sigurt mbulon edhe Komunën Deçanit,

- Për vitin 2021 janë strehuar gjithsej 6 gra nga mosha 18-45 vjeçare dhe 2 fëmijë, 2 -9 vjeçare
- Për viti 2022 gjithsej janë 8 gra nga mosha 32-56 vjeçe dhe 3 fëmijë të moshës 1-12 vjeçare
- Për viti 2023 janë gjithsej 5, një fëmijë i moshës 3 vjeçare dhe një vajzë e, ndaj të cilave është ushtruar dhunë në familje, qëndrimi i këtyre viktimave nuk është strikt i specifikuar, ndodhin raste që të qëndrojnë edhe më tepër se 6 muaj deri në Vendimet Gjyqësore⁵.

Në bazë të statistikave nga Policia e Kosovës, stacioni në Deçanit, raportohet se në vitin 2021 kemi pasur 27 raste të raportuara, prej tyre 3 janë viktima meshkuj, duke ju referuar moshës kryesisht mbizotëron mosha 15-60 vjeç, ndërsa në e vitit 2022 kemi raste të raportuara me një shifër 28, prej tyre 3 janë viktima meshkuj, mosha është ndryshme prej 18-60 vjeç dhe në vitin 2023 kemi pasur 30 raste prej tyre 5 janë viktima meshkuj, mosha prej 18-65 vjeç⁶.

Zgjidhje, pasi që qëndrimi në strehimoren “Shtëpia e Sigurt” është i përkohshëm, deri në 6 muaj, por në strehimore ndodh që për ndonjë rast më specifik strehimi t’i vazhdohet deri në 1 vit, por varësisht nga rasti ndodh që edhe deri në dy vite. Viktimat e dhunës në familje, pas qëndrimit gjashtëmuajor transferohen në strehimoret tjera (në regjionet tjera të Republikës së Kosovës), ku në çdo strehimore qëndrimi i tyre zgjat jo më tepër se gjashtë muaj. Mandej këto viktima të dhunës, nuk kanë zgjidhje tjetër, ose të kthehen në shtëpinë e gjinisë së tyre, ku shpeshherë ndodhë që mos t’i pranojnë edhe ato, ose të kthehen sërish tek kryerësi i cili ka ushtruar dhunë ndaj tyre, pasi që nuk mund të bëjnë zgjidhje tjetër.

Krahas numrit të raportuar, rastet e dhunës në familje mbeten më tepër raste të izoluara dhe shumë pak të raportuara. Nga ndryshimet e statistikave nga viti në vit, vërehet se ka një rritje të raportimit të rasteve të dhunës në familje në institucionet gjegjëse, që na bënë të kuptojmë se është rritur dukshëm vetëdijesimi qytetar për të raportuar dhunën krahasuar me periudhat e mëhershme, por njëkohësisht është rritur edhe besimi qytetar në institucionet që luftojnë këtë fenomen.

Viktima të dhunës në familje, marrë për bazë statistikën e vitit 2021, 2022 dhe 2023, kryesisht janë nga gjinia femërore.

⁴ Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Pejë - Dega në Deçan

⁵ Ardita Ramizi Bala- Drejtoreshë Ekzekutive e Qendrës për Mirëqenien e Gruas në Pejë që mbulon edhe Komunën e Deçanit

⁶ Stacioni i Policisë në Deçan

Frika dhe ndërjegjësimi i ulët për çështjet e dhunës në familje: Mos raportimi i dhunës në familje nga viktimat është ndër fenomenet më të shpeshta, pasi konsiderohet turp dhe një çështje që nuk duhet të dalë jashtë mureve të shtëpisë.

Mospranimi i dhunës seksuale: Për shkak të stigmës dhe ndëshkimit vërehet mos raportim i dhunës nga ana e viktimave dhe për këtë dhuna seksuale rezulton më pak e raportuar ose nuk ekziston fare në krahasim me dhunën fizike.

Probleme lidhur me trashëgiminë: Sa i përket procedurave të shqyrtimit të trashëgimisë, shumë herë ndodh që gruaja nuk njoftohet fare ose përjashtohet nga diskutimi për masën trashëgimore, qoftë në pozitën e bashkëshortes, nënës apo motrës dhe në këtë mënyrë diskriminohet. Veç kësaj, organi kompetent komunal për mbajtjen e librit amzë të vdekjeve ka për detyrë që në aktvdekje të shënojë emrat e trashëgimtarëve femra dhe meshkuj dhe assesit të mos i diskriminojë femrat.

KAPITULLI IV

KOHËZGJATJA E ZBATIMIT TË STRATEGJISË DHE INSTITUCIONET E PËRFSHIRA

Shtrirja kohore e strategjisë

Strategjia Komunale kundër Dhunës në Familje është paraparë si një strategji 4 vjeçare që do të zbatohet në periudhën 2024-2027.

Institucionet zbatuese dhe partnere

Komuna Deçanit: Institucioni kryesor zbatues për strategjinë është Komuna e Deçanit me drejtoritë e saj, si dhe Mekanizimi Institucional kundër dhunës në familje që do të kontribuojë në promovimin e ligjeve për mbrojtje nga dhuna në familje, si dhe atë të trashëgimisë dhe familjes, informim që ndikon në parandalimin e këtij fenomeni. Këto organe kanë për detyrë që të promovojnë mundësi të barabarta për të gjithë, pa marrë parasysh përkatësinë gjinore, fetare, etnike, moshë e racë, t'i promovojë vlerat për të drejtat e njeriut, si dhe të kujdeset për zbatimin e standardeve dhe raportimin mbi realizimin e tyre.

Ndër institucionet e tjera të përfshira në zbatimin e elementeve të caktuara të kësaj strategjie janë:

Policia e Kosovës, Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi – KKSB , Këshilli i Veprimit Rinor Lokal, OJQ-të .

Zyra për Punësim: Në koordinim me Qendrën për Punë Sociale, regjistron dhe evidenton personat të cilët lajmërohen në zyrë, ndaj të cilëve është ushtruar dhunë në familje. Këtyre personave në cilësi të punëkërkesve ju ofrohet: këshillim profesional, informim mbi

mundësitë e punësimit, përgatitje dhe ndërmjetësim në punësim, informim për aftësim dhe riaftësim profesional me qëllim përgatitjen për nevojat e tregut të punës.

Mbrojtësi i viktimave i cili bashkëpunon ngushtë me institucionet e tjera që ofrojnë ndihmë për viktimat e Dhunës në Familje dhe lloje të tjera të dhunës apo trafikimit të qenieve njerëzore, etj., si Policinë, QPS, Prokurorinë, Gjykatën, QKMF, Spitalin, Strehimoren, etj. Ndër detyrat e tij është të informojë viktimën për të drejtat ligjore, të parapara sipas ligjeve në fuqi për dhunën në familje, të parapërgatitë viktimën për seancat gjyqësore, e shoqëron gjatë seancave si në Prokurori dhe Gjykatë, etj.

KAPITULLI V

AKTIVITETET NË ZBATIM TË STRATEGJISË

(Plani i Veprimit të kësaj Strategjie gjendet i bashkëlidhur në Shtojcën 1)

Arritja e objektivave strategjike të kësaj Strategjie është paraparë të kryhet përmes zbërthimit të tyre në disa objektiva specifike me aktivitetet përkatëse.

Aktivitetet në planin e veprimit janë renditur sipas tre shtyllave bazë të përcaktuara edhe në Planin e Veprimit të Kosovës: Parandalim, Mbrojtje dhe Ri integrim. Për arritjen e objektivave të kësaj Strategjie, aktivitetet janë specifikuar edhe sipas prioritetit për zbatim:

Afatshkurtra: aktivitete të rëndësisë së lartë që duhet të zbatohen brenda një afati kohor të shkurtër 6 muaj – 1 vit. Të tilla mund të jenë ngritja dhe forcimi institucional për adresimin e Dhunës në Familje, çështje që lidhen me forcimin e mbrojtjes, etj.

Afatmesme: aktivitete të rëndësishme që duhet të zbatohen brenda periudhës kohore 1-2 vjeçare. Ndër aktivitete të tilla mund të jenë edhe ato që kërkojnë fonde, të cilat duhet të sigurohen nga institucionet gjegjëse për implementimin e kësaj strategjie.

Afatgjata: janë renditur të gjitha aktivitetet të cilat synojnë konsolidimin dhe qëndrueshmërinë afatgjatë të mbështetjes që u jepet të mbijetuarave prej Dhunës në Familje, shërbimeve cilësore, etj.

Aktivite në vijimësi: janë aktivitete, të cilat do të kryhen prej institucioneve zbatuese dhe atyre partnere në vijimësi, si pjesë e punës së tyre. Ndër to mund të përmendim aktivitetet që kanë të bëjnë me parandalimin, informimin dhe vetëdijësimin e komunitetit.

Objektivat specifike dhe disa prej aktiviteteve të planifikuara në Planin e Veprimit renditen si më poshtë:

FUSHA E VEPRIMIT – A. ELIMINIMI I PABARAZIVE GJINORE DHE DHUNËS NË FAMILJE

Objektiv Specifik A.1.

Eliminimi i stereotipeve gjinore për luftimin e dhunës në familje:

Aktivitete:

- Fushata vetëdijësuese dhe kampanja informuese mediatike për publikun e gjerë në komunën e Deçanit
- Trajnimet për barazi gjinore dhe dhunën në familje me përfaqësues të institucioneve komunale

Objektiv Specifik A.2.

Ngritja e vetëdijësimit të grave dhe të rinjve, institucioneve dhe OJQ-ve për pasojat e dhunës në familje dhe të pabarazive gjinore.

Aktivitete:

- Fushata (Aktivitete të barazisë gjinore dhe dhunës në familje, ligjërata, ese, dhe piktura me të rinjtë dhe grupe të ndryshme të interesit)
- Takime me gra dhe vajza në fshatra për të drejtat e tyre ligjore, me fokus në Dhunën në Familje. Gjatë takimeve do të shpërndahen informacione dhe fletëpalosje
- Debate të hapura dhe emisione televizive me tematika rreth Dhunës në Familje, me përfaqësues të institucioneve dhe të OJQ-ve

Objektiv Specifik A.3.

Fuqizimi i rolit të gruas në shoqëri përmes promovimit dhe rritjes së numrit të femrave në pozicionet vendimmarrëse

Aktivitete:

- Ndarja e përvojave të suksesshme të grave në pozita udhëheqëse gjatë takimeve me gratë dhe komunitetin

FUSHA E VEPRIMIT – B. ARSIMIMI DHE INFORMIMI

Objektiv Specifik B.1:

Ndërgjegjësimi i nxënësve dhe prindërve të Arsimit të Mesëm të Ulët dhe Arsimit të Mesëm të Lartë për çështjet e Dhunës në Familje

Aktivite:

- Aktivite informuese nëpërmjet mekanizmit koordinues, në kuadër të orëve mësimore dhe të fletëpalosjeve, broshurave, etj
- Informimi i prindërve për mekanizmin koordinues nëpërmjet zyrtarëve të arsimit
- Aktivite informuese dhe edukuese në kuadër të programit të aktiviteteve shkollore me pjesëmarrjen e nxënësve (orë mësimore, fushata, fletëpalosje)

Objektiv Specifik B.2:

Ngritja e kapaciteteve të mësimdhënësve të edukatës qytetare lidhur me Dhunën në Familje dhe trajtimin e saj

Aktivite:

- Organizimi i trajnimeve të mësimdhënësve të edukatës qytetare për çështje të Dhunës në Familje
- Organizimi i shkëmbimit të përvojave përmes vizitave studimore të specialistëve të kësaj fushe

Objektiv Specifik B.3:

Ulja e numrit të nxënësve që braktisin shkollën e mesme të ulët dhe të lartë si rezultat i Dhunës në Familje, në zonat rurale apo komunitete të ndryshme

Aktivite:

- Kryerja e hulumtimeve sociologjike mbi shkaqet kryesore të braktisjes së shkollës prej nxënësve
- Vetëdijesimi nëpërmjet liderëve të komuniteteve dhe ndërmjetësuesve përmes takimeve dhe punës me familje të veçanta që shfaqin probleme të Dhunës në Familje
- Aplikimi i masave ligjore që sanksionojnë braktisjen e shkollës

FUSHA E VEPRIMIT – C: FUQIZIMI I BAZËS EKONOMIKE**Objektiv Specifik C.1:**

Fuqizimi ekonomik i viktimave të dhunës në familje në përkrahjen për punësim dhe vetëpunësim

Aktivitetet:

- Regjistrimi, evidentimi dhe orientimi i viktimave të Dhunës në Familje
- Ofrimi i këshillave në prezantimin e dokumentacionit për aplikim të suksesshëm sipas tregut të punës
- Hartimi i kuadrit nënligjor, përmes nxjerrjes së një vendimi në nivel komunal, për lirimin nga taksat komunale për rastet e dhunës në familje në rastet e hapjes së një biznesi të ri

Objektiv Specifik C.2:

Mbështetje socio-ekonomike të mbijetuarve të Dhunës në Familje

Aktivitetet:

- Ofrimi i trajnimeve për ngritjen profesionale, informacioneve për mundësitë për biznes
 - Ofrimin e mbështetjes ekonomike me fond të veçantë prej komunës
 - Ndarja e subvencioneve për familjet në zonën rurale përmes ndarjes së subvencioneve për bujqësi si dhe hapja e bizneseve të vogla
- Përkrahje e Strehimores, rritja e kapacitetit për shkak të numrit të strehuarve jo i mjaftueshëm, për kryerjen e shërbimeve dhe mbështetjen e të mbijetuarve të Dhunës në Familje si dhe bashkëpunimi me mekanizmat që merren me çështjet e dhunës në familje

Objektiv Specifik C.3:

Zgjidhje e strehimit për rastet e të mbijetuarve të Dhunës në Familje

Aktivitetet:

- Ofrimin e mbështetjes ekonomike përmes pagesës së qirasë për rastet e pazgjidhura

FUSHA E VEPRIMIT – D: FUQIZIMI DHE BASHKËPUNIMI NDËRINSTITUCIONAL

Objektiv Specifik D.1:

Fuqizimi i Mekanizmit koordinues në nivel të komunës

Aktivitetet:

- Takime me strukturat udhëheqëse të komunës për qartësimin e roleve dhe përgjegjësi
- Takime periodike të Mekanizmit Koordinues për shkëmbim informacioni dhe koordinim aktivitetesh.

Objektiv Specifik D.2:

Rritja e vetëdijes për identifikimin sa më të hershëm të situatave të rrezikut për Dhunën në Familje prej secilit institucion dhe planifikimin e masave parandaluese

Aktivite:

- Identifikimi i rasteve të dhunës në Familje
- Regjistrimi në data bazë dhe vlerësimi i nevojave të mbijetuarve të Dhunës në Familje.

KAPITULLI 6

PLANI I MONITORIMIT DHE I VLERËSIMIT TË PROGRESIT NË ZBATIM

Për monitorim dhe zbatimin të kësaj strategjie obligohet Komuna e Deçanit dhe institucionet tjerë të përmendur në këtë dokument.

Institucionet përgjegjëse për zbatimin e aktiviteteve të saj si dhe ato partnere duhet të informojnë në mënyrë të rregullt Zyrën e Kryetarit me anë të të dhënave mbi arritjen e objektivave dhe realizimin e aktiviteteve të përcaktuara.

Të paktën një herë në vit, Kryetari i Komunës raporton në Kuvendin e Komunës mbi progresin në zbatimin e strategjisë sipas treguesve të përcaktuar për çdo drejtim strategjik.

Komuna e Deçanit

PLANI I VEPRIMIT PËR MBROJTJE NGA DHUNA NË FAMILJE (2024-2027)

Aktivitetet	Veprimet	Buxheti			Total	Komuna Donatorët	Afati i zbatimit	Institucioni Përgjegjës dhe mbështetës	Indikatori i suksesit
		2024	2025	2027					
FUSHA E VEPRIMIT- A: .ELIMINIMI I PABARAZIVE GJINORE DHE DHUNËS NË FAMILJE									
Deri ne vitin 2027, strategjia lokale synon të ndryshojë qasjen në familje dhe shoqëri për eliminimin e pabarazisë gjinore dhe dhunën në familje.									
1.Eliminimi i stereotipave gjinore për luftimin e dhunës në familje	Fushata vetëdijesuese dhe kampanja informuese mediatike për publikun e gjerë në komunën e Deçanit për dhunën në familje. Bashkëpunimi me mediat për të transmetuar mesazhe ndërgjegjësuese; Përdorimi i platformave/mediave sociale për të	150 €	150€	150€	450€		2024-2027	Njësia për të Drejtat e Njeriut, QPS, Komuna, OJQ-të Mediat e tjera Vendore.	Prej rreth 38.496 banorëve , rreth 35% e tyre kanë marr mesazhin dhe janë bërë pjesë e aktiviteteve ndërgjegjësuese

	<p>arritur një audiencë më të gjerë;</p> <p>Organizimi i një seri video-klipesh të shkurtra ku të mbijetuarat ndajnë historitë e tyre dhe theksojnë rëndësinë e luftimit të stereotipeve gjinore.</p>								
	<p>Trajnimet për Barazi gjinore dhe dhunën në familje me përfaqësues të instucioneve vendore.</p> <p>Për t’i ndihmuar pjesëmarrësit të aplikojnë njohuritë e tyre në mënyrë efektive, planifikohet:</p> <p>Përfshirja e skenarëve praktikë dhe studimeve të</p>	S’ka kosto	S’ka kosto	S’ka kosto					

	<p>rasteve gjatë sesioneve të trajnimit;</p> <p>Ushtrime të rolit ku pjesëmarrësit praktikojnë reagimin ndaj situatave të dhunës në familje.</p>								
<p>2. Ngritja e vetëdijesimit të grave dhe të rinjve , institucioneve dhe bizneseve për pasojat e dhunës në familje dhe të pabarazisë gjinore</p>	<p>6 takime me gra dhe vajza në fshatra për të drejtat e tyre ligjore, me fokus për dhunën në familje.</p> <p>Gjatë takimeve do të shpërndahen informacione dhe fletëpalosje.</p> <p>Sesione për fuqizimin ligjor për të edukuar gratë dhe të rinjtë rreth të drejtave të tyre ligjore dhe rrugëve</p>	100€	100€	100€	300€		2024-2027	Komuna + Donatorët	

<p>për të kërkuar ndihmë në rastet e dhunës me bazë gjinore.</p> <p>3 fushata me temë të barazisë Gjinore dhe Dhunës në Familje, ligjërata ese ose piktura me të rinjtë.</p> <p>Organizimi i një ekspozitë arti ku artistë të rinj krijojnë pjesë që përshkruajnë ndikimin e dhunës në familje dhe promovojnë barazinë gjinore.</p> <p>Përfshirjen e grave udhëheqëse lokale ose gratë model në komunitet si folës të ftuar gjatë këtyre</p>								
--	--	--	--	--	--	--	--	--

	takimeve. Të ftuara do të jenë gra sipërmarrëse të suksesshme ose një avokate e specializuar për çështje familjare për të ndarë përvojat dhe njohuritë e tyre.								
3. Fuqizimi i rolit të gruas në shoqëri përmes promovimit dhe rritjes së numrit të femrave në pozicionet vendimmarrëse.	Ndarja e përvojave të suksesshme të grave në pozita udhëheqëse gjatë takimeve me gratë dhe komunitetin. Planifikohen 3 takime, një për çdo vit. Organizimi i një paneli me gra të suksesshme që ndajnë përvojën e tyre për të arritur në pozitë vendimmarrëse.	S'ka kosto	S'ka kosto	S'ka kosto			2024-2027	2024-2027 Drejtoria e Kulturës	Rritja e përqindjes së grave pjesëmarrëse aktive në takime.

	Mbajtja e sesioneve për fuqizimin ligjor për të edukuar gratë dhe të rinjtë rreth të drejtave të tyre ligjore dhe rrugëve për të kërkuar ndihmë në rastet e dhunës me bazë gjinore.								
Total					750 €				

FUSHA E VEPRIMIT -B: ARSIMI DHE INFORMIMI

Deri ne vitin 2027, strategjia lokale synon një komunitet të mirë informuar, edukuar në çështjet e dhunës në familje me profesionistë të aftë dhe të përgatitur për të parandaluar, njohur dhe kualifikuar për trajnimin adekuat të viktimave të dhunës në familje dhe të komunitetit në tërësi.

5.Aktivite informuese me nxënës dhe mësimdhënës	Vendosja e postarëve nëpër institucione: shkolla, QPS, institucione shëndetësore (përdorimi i teknologjisë informative) për ndërgjegjësim si dhe sesione të	100 €	100 €	100 €	300 €			Drejtoria e Arsimit Shkollat e Mesme të Larta Qendra për Punë Sociale	Postarët e vendosur në shkolla Informim për dhunën në familje të komunës sonë. Sesione të diskutimit në klasë, prezantime nga ekspertë të fushës, dhe trajnime
--	---	-------	-------	-------	-------	--	--	---	--

	diskutimit në klasë, prezantime nga ekspertë të fushës, dhe trajnime për mësimdhënësit për të trajtuar temën në mënyrë më të plotësuar dhe efektive.								për mësimdhënësit për të trajtuar temën në mënyrë më të plotësuar dhe efektive.
	Krijimi i video, infografikave dhe artikujve online, që do të ndahen me nxënësit dhe mësimdhënësit përmes platformave/rrjeteve sociale.	50 €	50 €	50 €	150 €			Drejtoria e Arsimit	Materiale të ndryshme mbishkrim për parandalim që do të shpërndahen në platformat në shkolla të komunës sonë.
6.Ndërgjegjësi mi i prindërve dhe i nxënësve të AMU dhe në AML për çështjen e	Aktivitete informuese nëpërmjet mekanizmit koordinues në kuadër të orëve mësimore dhe të	50 €	50 €	50 €	150 €				Deri në vitin 2027 rreth 50% e nxënësve dhe prindërve janë të ndërgjegjësuar për DH.F

dhunës në familje	fletëpalosjeve broshurave, etj								
	Informimi i prindërve për mekanizmin koordinues nëpërmjet zyrtarëve të Arsimit								
	Aktivitete informuese dhe edukuese në kuadër të programit të aktiviteteve shkollore me pjesëmarrjen e nxënësve (orën mësimore ,fushata postere etj.)	50 €	50 €	50 €	150 €				
7.Ulja e numrit të nxënësve që braktisin shkollën e ultë dhe të lartë si	Kryerja e hulumtimeve sociologjike mbi shkaqet kryesore të braktisjes së shkollës prej	S'ka kosto	S'ka kosto	S'ka kosto				Drejtoria e Arsimit OJQ-të Mekanizmi	Deri në vitin 2027, në bashkëpunim me Ekipin për Parandalim dhe Reagim të Braktisjes në Shkolla dhe atij të

<p>rezultat i DH.F në zonat rurale</p>	<p>nxënësve të familjeve ku ushtrohet dhunë. Do të bëhen hulumtime ku mund të përfshihen intervista me nxënësit, prindërit, dhe stafin shkollor për të identifikuar shkaqet specifike dhe për të përmirësuar strategjitë e intervenimit. Pas kryerjes së hulumtimeve, është e rëndësishme që rezultatet e tyre të përdoren për të planifikuar veprimet e ardhshme për të parandaluar numrin e nxënësve që braktisin shkollën për shkak të dhunës në familje.</p>								<p>Koordinues</p>	<p>nivelit komunal të angazhohen që niveli i braktisjes së shkollimit mbi bazën e dhunës në familje të mbetet 0.</p>
---	--	--	--	--	--	--	--	--	-------------------	--

	<p>Planifikimi i veprimeve duhet të bazohet në analizën e rezultateve dhe të përfshijë masa konkrete për të adresuar shkaqet e identifikuara.</p> <p>(Shembull, nëse hulumtimet identifikojnë mungesën e mbështetjes për nxënësit e prekur nga dhuna në familje, mund të propozohen programe mbështetëse në shkolla ose trajnime për stafin shkollor për të menaxhuar këtë problematikë).</p>				750 €				
Totali :									

FUSHA E VEPRIMIT- C: FUQIZIMI I BAZËS EKONOMIKE Deri në vitin 2027, strategjia lokale synon në parandalimin, të ndryshojë qasjen në familje dhe shoqëri për eliminimin e pabarazisë gjinore dhe dhunën në familje të tyre.										
8. Fuqizimi Ekonomik i viktimave të dhunës në familje në përkrahje për punësim dhe vetëpunësim	Regjistrimi, Evidentimi dhe orientimi i viktimave të DHF pranë Komunës dhe OJQ ku organizohen aktivitete e ngjarje nga Organizata të ndryshme me ekspert të fushave të shumta.	S'ka kosto	S'ka kosto	S'ka kosto				2024-2027	MKKDF Komuna Institucion et partnere	Brenda 3 viteve, sistemi i regjistrimit dhe orientimit bëhet funksional sipas standardeve kombëtare në përpunim
	Ofrimi i këshillave në prezantimin e dokumentacionit për aplikim të suksesshëm sipas tregut të punës, ku parashihen të organizohen edhe seminare ose	S'ka kosto	S'ka kosto	S'ka kosto						

	trajtime të specializuara për viktimat e dhunës në familje për t'u përgatitur për tregun e punës.								
	Hartimi i kuadrit nënligjor, përmes nxjerrjes së një vendimi në nivel Komunal, për lirim nga taksa komunale në rastet e hapjes së një biznesi të ri për viktimat e dhunës në familje	S'ka kosto	S'ka kosto	S'ka kosto			2024-2027	Qendra për punë sociale, Zyra e punësimit, Donatorët sipas përcaktimit të standardit kombëtar	
9. Mbështetja socialoekonomike e të mbijetuarave të DH.F	Ofrimi i mbështetjes ekonomike me fond të veçantë prej Komunes							Komuna, Institucionet et partnere, sipas përcaktimit	Sa më shumë gra të përfitojnë nga shërbimet në këtë kategori deri në 50%

DRAFT STRATEGJIA KOMUNALE KUNDËR DHUNËS NË FAMILJE

	Ndarja e subvencioneve për familjet e zonave rurale përmes ndarjes së subvencioneve dhe përkrahja e bizneseve të vogla	500€	500€	500€	1500 €		2024-2027	t të standardeve ndërkombëtare , Komuna, Drejtoria e	
	Përkrahja e strehimores “Shtëpia e Sigurt” për kryerjen e shërbimeve dhe mbështetjen e të mbijetuarave të DH.F	3000 €	3000 €	3000 €	9000 €		2024-2027	Mirëqenies Sociale, Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik , Sektori për të Drejtat e Njeriut dhe Komunitet e, Institucion e Partnere, OJQ-të dhe Donatorët.	Strehimorja mbështetet për shpenzimet bazike

10.Zgjidhja afatmesme e strehimit për rastet e mbijetuarave të DHF	Pagesa e Qirasë për vendstrehimin e viktimave të dhunës në familje	3000 €	3000 €	3000 €	9000 €			Komuna , Institucion et partnere, Donatorët	
	Ofrimi i mbështetjes ekonomike përmes pagesës së qirasë për rastet e pazgjidhura								
Total					19.500€				

FUSHA E VEPRIMIT- D: FUQIZIMI DHE BASHKËPUNIMI NDËRNACIONAL

Deri në vitin 2027, strategjia lokale synon të ketë institucione funksionale dhe të mirë koordinuara për parandalimin, mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje dhe riintegrimin e tyre dhe të familjeve në jetën ekonomike dhe sociale të komunës.

11.Institucionalizimi i Mekanizmit Koordinues kundër Dhunës në Familje në nivel të komunës	Takime me strukturat udhëheqëse të komunës për qartësimin e roleve dhe përgjegjësi	200€	200€	200€	600€		2024-2027	MKKDHF	Të paktën 4 takime të organizuara çdo vit
---	--	------	------	------	------	--	-----------	--------	---

	Takime periodike të Mekanizmit Koordinues kundër Dhunës në Familje për shkëmbim informacioni dhe koordinimin e veprimeve konkrete.	50 €	50 €	50 €	150 €		2024-2027		
12 Rritja e vetëdijes për identifikimin sa më të hershëm të situatave të rrezikut për DH.F prej secilit institucion planifikimin e masave parandaluese	Hartimi i formularëve të posaçëm për raportimin e rasteve të rrezikut për DH.F dhe rasteve të identifikuara						2024-2027	MKDHF	Deri në vitin 2027, institucionet e komunës do të kenë të ngritur sistemin e identifikimit, regjistrimit dhe planifikim e masave parandaluese
	Identifikimi i shkaqeve që paraprinë rastet e DH.F përmes analizimit me anë të anketimeve në shkolla, institucione						2024-2027	MKDHF, Institucionet partnere, OJQ-të dhe shkollat	Deri në vitin 2027 të dhëna për shkaqet dhe situatën janë të mbledhura në bazë periodike

	shëndetësore, diskutimeve mediatike me specialistë								
	Planifikimi i punës dhe mbështetja institucionale për grupet me vunerabël DH.F (përfshirë pleqtë, të rinjtë dhe njerëzit me nevoja të veçanta	1000€	1000€	1000€	3000€			MKDHF, Institucionet partnere, OJQ-të dhe shkollat	Raste të ndihmuara dhe të rehabilituara
Total:		8.250€	8.250€	8.250€	3.750 €				
Gjithsej :					28.500€				



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DEÇANIT
MUNICIPALITY OF DECAN
OPSTINA DECANI



RAPORTI I PUNËS SË KOMITETIT PËR KOMUNITETE TË KOMUNËS SË DEÇANIT PËR PERIUDHËN JANAR - QERSHOR 2024

Komiteti për Komunitete në Deçan, funksionin e vetë të punës e kryen në harmoni dhe në përputhje me dispozitat ligjore, në harmoni me rregulloret e pushtetit qendror dhe atë të pushtetit lokal.

JANAR

Mbledhja e parë e rregullt e Komitetit për Komunitete, e mbajtur më 12.01.2024.

Në takim morën pjesë: anëtarët e Komitetit për Komunitete, OSBE, UNMIK-u, PK-ja.

Shqyrtimi, analiza dhe aprovimi i Raportit vjetor të punës dhe aktivitetit të Komitetit për Komunitete për vitin 2023.

Shqyrtimi, analiza dhe aprovimi i planit të punës për vitin 2024.

Gjatë këtij muaji, nuk ka pasur ndonjë rast të personave të riatdhësuar ka pasur konsultime me qytetarë nga komunitetet për nevoja të ndryshme kryesisht rreth ndihmës në pajisje me dokumente personale, të cilëve ju është ofruar ndihma nga zyra e ZKK-së

Raporti i zyrës për komunitete rreth punës dhe aktivitetit brenda vitit paraprak.

SHKURT

Mbledhja e dytë e rregullt e Komitetit për Komunitete, e mbajtur më 16.02.2024.

Në takim morën pjesë: anëtarët e Komitetit për Komunitete, OSBE, UNMIK-u, PK-ja.

Gjatë këtij muaji nuk ka pasur ndonjë rast të personave të riatdhesuar, ka pas kërkesa për ndihmë rreth plotësimit të dokumenteve për grante dhe subvencione të cilëve ju është ofruar ndihme nga ZKK-ja rreth plotësimit të aplikacioneve.

Raportim nga Zyra për Komunitete dhe Kthim dhe Integritet Evropiane rreth punës dhe aktiviteteve nga viti paraprak : raportin para të pranishmëve e paraqiti z, Artan Ismajlaj Zyrtar i Lartë për Integritet Evropiane.

Raporti i punës njëvjeçar Janar-Dhjetor 2023 kaloi pa asnjë kundërshtim.

MARS

Mbledhja e tretë e rregullt e Komitetit për Komunitete, e mbajtur më 15.03.2024.

Në takim morën pjesë: anëtarët e Komitetit për Komunitete, OSBE, UNMIK-u, PK-ja.

Gjatë këtij muaji, nuk ka pasur ndonjë rast të personave të riatdhesuar, ka pas kërkesa për pajisje me dokumente personale nga pjesëtarët e komunitetit të cilëve u është ndihmuar nga ZLK-ja.

Sa i përket raportit nga Drejtoria Komunale për Arsim rreth gjendjes aktuale me vijueshmërinë e nxënësve të komunitetit jo shumicë në shkollë, nga kjo Drejtori ishte prezent zyrtari z, Ramiz Bajramaj i cili i njoftoi të pranishmit se këtë vit kemi një rast të braktisjes së shkollimit të detyrueshëm.

Përkundër të gjitha përpjekjeve që janë bërë nga shkollë ku nxënësi i lartcekur ka vijuar mësimet SH.F.M.U "Maxhun Çekaj" Irzniq, vizita të vazhdueshme në familjen e nxënësit me qëllim të kthimit në procesin e rregullt mësimor kanë rezultuar të pasuksesshme.

Nga të pranishmit u propozua që të organizohet një fushatë vetëdisuese neper shkollat e Komunës së Deçanit rreth kësaj problematike (braktisjes së shkollimit të rregullt).

PRILL

Mbledhja e katërt e rregullt e Komitetit për Komunitete, e mbajtur më 12.04.2024.

Në takim morën pjesë: anëtarët e Komitetit për Komunitete, OSBE, UNMIK-u, PK-ja.

Gjatë këtij muaji, nuk ka pasur ndonjë rast të personave të riadhesuar, ka pasur kërkesa për vërtetime të personave të riadhesuar të cilëve ju është ofruar ndihma nga zyra e ZKK-së.

Pjesëtarët e komuniteteve gjatë këtij muaji kanë përfituar ndihma ushqimore dhe higjienike nga Qendra për Punë Sociale dhe shoqatat humanitare me rastin e festës së Fiter Bajramit.

MAJ

Mbledhja e pestë e rregullt e Komitetit për Komunitete, e mbajtur më 10.05.2024.

Në takim morën pjesë: anëtarët e Komitetit për Komunitete, OSBE, UNMIK-u, PK-ja.

Gjatë këtij muaji, nuk ka pasur ndonjë rast të personave të riadhesuar.

I pranishëm në këtë mbledhje ishte edhe i pari i Komunës së Deçanit z; Bashkim Ramosaj i cili njoftoi se pranishmit me gjendjen e sigurisë në Komunën e Deçanit e cila paraqitet e shumë e mirë.

Regjistrimi i popullsisë është duke u bërë në Komunën e Deçanit, proces që do të zgjas deri më datë 17.05.2024 dhe ftoj qytetarët të përgjigjen sa më shumë kësaj procedure që shkon në të mirë të tyre komunës dhe shtetit tonë.

Sa ju përket kërkesave të komunitetit jo shumice nuk dallojnë nga ato të pjesëtarëve të komunitetit shumicë e që kryesisht kanë të bëjnë me infrastrukture: rrugë, ujësjellës, kanalizim, ndriçim etj.

Dëshira ime si kryetarë do të ishte që këto kërkesa të ishin për zhvillim punësim sepse mundësitë janë të mëdha falë resurseve natyrore që i ka komuna e Deçanit, porse sfida dhe problemi kryesorë mbetet ndarja e buxhetit nga niveli qendror për komunën e Deçanit që është minimal dhe pamundëson shfrytëzimin e këtyre resurseve natyrore.

Si lajm te mire pas një kohe te gjatë e kemi fituar te drejtën shfrytëzimin të pronave me interes publik në Parkun Kombëtarë "Bjeshkët e Nemuna".

Gjatë këtij muaji nga Komiteti për Komunitete ka vizituar vendbanimet ku gravitojnë më shumë komunitetet jo shumicë siç janë fshatrat Gramaçel dhe lagjen Pemishte.

Ku jemi njoftuar për së afërmi me problemet që përballen ky komunitet që kryesisht kanë qenë probleme të infrastrukturës: ndriçim publik, asfaltim i rrugëve dhe rregullim i rrjetit të ujërave të zeza.

Gjithashtu janë bërë vizita në dy shkolla ku gravitojnë më shumë nxënësit e komunitetit jo shumicë. Ne shkollën fillore "Rexhep Kadrijaj" në Rastavic dhe në shkollën fillore "Drita" në Gramaçel. Nga Drejtoritë e shkollave te lartcekura u njoftuam se nxënësit e komuniteteve jo shumice janë te integruar plotësisht, ne përjashtim te shkollës Rexhep Kadrijaj ne Rastavic, ku një numër i caktuar i nxënësve nga komuniteti jo shumice nuk vijojnë mësimet me rregull dhe ne këtë dukuri e kemi konstatuar si Komitet dhe e kemi deleguar te organi përgjegjës.

QERSHOR

Mbledhja e gjashtë e rregullt e Komitetit për Komunitete, e mbajtur më 14.06.2024. Në takim morën pjesë: anëtarët e Komitetit për Komunitete, OSBE, UNMIK-u, PK-ja.

Gjatë këtij muaji nuk ka pasur ndonjë rast të personave të riatdhesuar, ka pasur një kërkesë nga një familje nga fshati Glllogjan për kycje ne sistemin e kanalizimit, ku te njëjtëve ju është ndihmuar nga ZKK për hartimin e kësaj kërkesë dhe adresimin e saj tek zyra përkatëse.

Gjate kësaj mbledhje raportoj Drejtoresha për Buxhet dhe Financa Znj, Dafina Cacaj: e njëjta i njoftoj te pranishmit se qarkorja e pare Buxhetore vetëm se ka mbërri dhe se janë ne fazën e mbledhjes se informacioneve nga drejtoritë e ndryshme për nevojat e ndryshme buxhetore.

Drejtoresha i inkurajoj përfaqësuesit e komuniteteve jo shumice pranë Komitetit për Komunitete që të paraqesin kërkesa konkrete dhe se te njëjtat do te shqyrtohen.

ZKK se bashku me Komitetin për Komunitete i ka ndihmuar anëtarët e Komuniteteve që ti hartojnë kërkesat e komuniteteve në një kërkesë të përbashkët,

dhe të njëjtat i janë dorëzuar Drejtorisë për Buxhet dhe Financa dhe Komitetit për Politik dhe Financa.

Kryesuesi

Shkelzen Berisha



KUVENDI KOMUNAL - DEÇAN

Municipal Assembly of Decan

TRANSKRIPTI

DEÇANI

**Mbledhjen e Kuvendit të Komunës
(Legjislatura e VII, mbledhja e VII) me dt.31.07.2024**



DEÇAN

31 Korrik 2024

Procesverbal

Hajdar Sutaj

Kryetar i komunës zotëri Bashkim Ramosaj, të nderuar drejtorë të drejtorive të respektuar anëtare anëtare të kuvendit të komunës së Deçanit, mirë se keni ardhur në mbledhjen e 7-të të rregullt të kuvendit të komunës së Deçanit për vitin 2024. Për mbledhje propozoi këtë rendë pune, shqyrtimi dhe miratimi i transkriptit nga mbledhja e datës 31.01.2024 dhe transkriptet e mbledhjes 31.05.2024, transkript nga mbledhja datës 11.06.2024, shqyrtimi i raportit gjashtëmujor financiar, shqyrtimi i raportit të auditorit të jashtëm për vitin 2023 dhe plani e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të zyrës kombëtare të auditorit.

5 Shqyrtimi i raportit gjashtëmujor të komitetit të komuniteteve realisht e kemi largu si pikë. Shqyrtimi i draft planit zhvillimor të arsimit 2024-2027, dhe e 7-ta është rialokim i mjeteve financiare në kategorinë e investimeve kapitale. E te të ndryshmet e kemi me kërkesë të ministrisë, administratës publike. Nje rekomandim që japim ekzekutivt për një vendim që kemi marë në seancën paraprake me datën 28.04 për këmbimin e pronës, të një rruge Dashinovic lagjia Sadikaj po ashtu si kërkesës e Isuf Sadikaj në cilën rekomandohet që egzekutivi të bëjë vlerësimin financiar të 2 pronave. Nëse ka najkush diçka më thonë, ju njoftoj po ashtu që, pika e 2-të raporti gjashtëmujor i kryetarit të komunës dhe pika e 6-të cilën e keni e 5-ta realisht shqyrtimi i raportit gjashtëmujor të komitetit të komuniteteve është larguar me vendim të KPF-s për shkak se nuk kemi pasë ndikon nga zyrat përkatëse me e mbrojtë këtë pikë.

A ka dikush diskutim për rendin e ditës. Po Albesa Cacaj e ka fjalën

Albesa Cacaj

Atëher përshëndetje për të gjithë zotri kryesus kamë 2 pyetje që kanë të bëjnë me planin e punës së kuvendit për vitin 2024, në muajin maj është paraparë që të sjellat raporti i planit të veprimit rinor lokal në Deçan, i cili është miratuar tash e një vit, pra në qershor 2023-tës e kom bo pyetje edhe në muajin maj, keni thënë që e sjellni në qershor as në qershor nuk është sjellë.

Pastaj pyetja numër 2 ka të bëjë me planin e punës të muajit qershor pika numër 3 shqyrtimi i raportit për barazi gjinore as ky raport nuk është sjellë në muajin qershor të paktën prita që këtë muaj të vijë. Doja të dija arsyet, faleminderit.

Hajfar Sutaj

Faleminderit Albesa, dikush tjetër. Atëherë e nderume kolege, plani i veprimit rinor lokal është hartuar në vitin e kaluar edhe gabimisht e kemi futur në plan pune këtë vit, sepse nuk ka nevojë për me pasë një miratim të ri, ndërsa sa i përket raportit të planit të punës për barazi gjinore nuk e ka pregadit askush, edhe nuk kemi mundur me shti në rend te ditës që me largu.

A ke diçka shtesë, po urdhëro Albesa Cacaj e ka fjalën.

Albesa Cacaj

Nuk ka te bëj i nderuar kryesus me miratim sepse është miratuar plani ka të bëjë me raportim, brenda një vitit, cilat objektiva qëllime janë arritur sepse ka të bëjë me të rinjët deçanas edhe një çështje tjetër që harrova paraprakisht me cekë është raporti i punës së komitetit për komunitete, e kam lexuar që u largua nga rendi ditës edhe jam e interesuar me dit cila ka qenë arsyeja pse është larguar, edhe pse mos me ardhë në asamble me u trajtu. Shkak ka qenë mosprezenca e personit adekuat për me mbrojt dhe e kuptova që ju nuk e keni njoftuar kryesuesin e komitetit për

me ardh me e mbrojt ne KPF ai ka qenë i njoftun veç për me ardhë në asamble, faleminderit.

Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë.

Realisht sekretarja e kuvendit më ka thënë se e ka njoftuar. Faleminderit shumë sa i përket raportit do ta diskutojmë nëse, jo tani meqenëse nuk e kemi atëher shikojm për në seancën e radhës, kush është për këtë rend dite?

A kundër?

A ka abstenim?

Konstatoj që kuvendi komunal mënyrë unanime ka miratuar rendin e punës për takimin e sotëm. Te pika e parë shqyrtimi dhe miratimi i transkriptit të datës 31.01, 31.05 dhe datës 11.06.2024. Po ashtu e keni edhe të datës 28.06 e që e ka ndjekur sekretaria e kuvendit, po ashtu keni edhe 1 letër të cilën na kanë dërguar operatori i cili e mirëmban ose e përcjell transkriptin e seancave. A ka dikush diçka më thanë Orges Tafilaj e ka fjalën.

Orges Tafilaj

Faleminderit kryesues, përshëndetje për të gjithë. Realisht neve na kanë ardhur transkriptet e kërkuara të përmirësuara, megjithatë prapë nuk janë në nivelin e duhur. Edhe transkriptin që e kemi në email prapë nuk është në nivelin që duhet të jetë të njëjtën kohë e cekë edhe vetë që ne kemi pranuar një email përcjell nga ty, të zotëriut Vigan Ajazi dhe kisha kërku nga ju a keni pasë kontakt me të dhe cila ka qenë përgjigja e tij për problemet që kemi, për mua arsyetimet që i kemi në email janë thjesht arsyeime dhe nuk ka të bëjë me problematikën që e diskutojmë faleminderit.

Hajdar Sutaj

Faleminderit Orges është shqetësim me vend, unë zyrtarisht ju kam drejtuar atij edhe aj zyrtarisht ma ka kthyer emailin te cilën ju e keni dhe po shpresoj që gjatë javës që vijmë me e pritë me ni takim dhe bashkë me sekretaren e kuvendit, me i definu domethënë këto gabime, përndryshe na duhet me e shkëput kontratën me të dhe me vazhdu sistemin e procesit, proces mbajtjes kështu, do me thënë nëse nuk kemi ndonjë përmirësim, tendenca ka qenë për ta bërë më mirë siq shihet ka probleme ose nuk është duke funksionuar në mënyrën qysh ne e kemi menduar Ose do ta bëjmë zgjidhjen, ose do ta shkëputim marrëveshjen e bashkëpunimit që e kemi me ta.

A doni të qesim në votim këto transkripta, apo nuk doni, të katërtat? Këto të cilat i ka dërguar sekretarja e kuvendit, 3-at edhe i ka edituar. Unë i qes në votim për ti votuar.

Kush është për, për katër transkriptet. Faleminderit

Kush është kundër? Faleminderit

Kush abstenon?

I kemi 3 vota kundër, i kemi 6 vota abstenim, edhe 13 vota janë për, e kemi votuar transkriptet e mbledhjeve të kaluara. Jemi te pika e dytë që në listë e keni pikën e tretë është shqyrtimi i raportit gjashtëmujor financiar. Fillimisht ja kisha kalu fjalën drejtoreshës për buxhet dhe financa zonjës Dafina Cacaj

Dafina Cacaj

Të asambles e keni edhe raportin financiar janar - qershor 2024 pra 6 mujorit të pare. Në KPF e kemi diskutu pak sipërfaqësisht me antarët e komitetit e disa pyetje që kanë pasur ata në lidhje me kodet ekonomike, të cilat nuk janë ndoshta shumë të qarta çka është paguar për mes ati kodi ekonomik, mundeni me shkarku në faqen e ministrisë është plani kontabël qështja për punë për

vitin 2024, unë e shkarkova po për çkado që keni unë mundem prapë me vazhdu me ju përgjigj edhe nëse nuk mundeni me e gjet. Përshembull te shtesat tranzitore keni pasur pyetje. Janë paga shtesë me të cilat ligji i pagave jau ka ul pagën, mirëpo edhe për 2 vjet dhe se di saktë nëju del pagë shtesë ajo pjesë me barazu me pagën të cilën e kanë marrë deri në aprovim të ligjit, rasti është te auditort të brendshëm dhe te kryetari, nuk e di a e ka nënkryetari edhe ndokush tjetër. Te kujdestaria e punëve shtesë dhe punët jashtë orarit është për ato vendime që i kanë zyrtarët për punë jashta asaj çka kanë me akt emërim kanë edhe punë shtesë tjerat me të cilat mund ti kompensojmë, dhe ligji jua lejon në listën e pagave. Tjera pyetje kemi pasë shtesa të veçanta për të zgjedhurit, edhe kjo hyn në të njëjtën kategori domethonë çka fillojnë me 3 numrat e parë 1 1 1 janë të gjitha që kalojnë përmes listës së pagave dhe janë ato mjetet që kalkulohen nga pagat që ju dalin zyrtarëve ose juve. E transferet sociale për individ janë bursat e studentëve që 6 mujorin e parë kanë mujt me dal vetëm 2 të tjerat janë refuzu, tash janë kryer tjerat edhe 4 janë refuzuar prap po edhe ato tashë i rregullojm. Për shkak që kanë ndryshu disa emërtime në kode ekonomike edhe për neve nuk është e lehtë me jau përshtatë, ose unë me i ditë të gjitha se janë shumë kode ekonomike shumë përshkrime, ne mundohemi me i përshtat me ata që i shkon më së shumti asaj fature ose asaj qka ne jemi ka dojm me pagu, edhe pse në këtë rastin e bursave nuk është kod që e kemi zgjedh ne po, ministria e financave kur e ka bërë shpenzimin, ajo ju ka dokë më e përafërta ose nuk ka pasurë tjetër përshkrim për bursa. Të tjera pyetje të paqarta nuk kam pasur nëse keni ju diçka tjetër mundeni me vazhdu sod publikohet edhe në web faqe, qysh edhe na takon me ligjë, e kam pasë edhe sa është dëmtuar komuna nga përmbarimet, vlera totale është 4,073,508 euro e nuk kamë mundur me nda sa kanë qenë..përshembull borxhi kryesor..edhe sa janë kamata ndëshkime për shkak se na nuk e kemi këta, te ne merret vetëm parat edhe nuk mundemi me pa sa janë, mundemi te avokati, por nuk ka mundur me i bë prej të hënës deri sod me i nda për krejt sa kanë qenë nga fillimi deri sod kamata ndëshkime momentin që i kemi mundem me i sjellë masandej faleminderit.

Hajdar Sutaj

Faleminderit për sqarimet drejtoreshë dhe për fjalën.

Atëher ne e kalojmë te diskutimet fillimisht në emër të subjekteve politike nga AAK Arjan Dobraj e ka fjalën.

Arjan Dobraj

Faleminderit kryesus Sutaj i nderuar kryetar Bashkim Ramosaj, të nderuar kolegë e kolege, te nderuar anëtarë të ekzekutivit.

Si grup konsiderojmë që me raport gjashtëmujor financiar është ndër 2 ose 3 ma të mirët në kohën e fundit që na ka ardhë për shkak të qartësisë që e ka, realisht patëm disa paqartësi në lidhje, sidomos me bursat që sapo na dha sqarimin drejtoresha dhe në lidhje me shifrën që ka marrë përmbaruesi të cilën edhe ata e potencove diçka nuk kemi për me shtu tjetër, po ashtu nëse ka dikush nga kolegët me shtu diçka faleminderit.

Hajdar Sutaj

Faleminderit Arjan. Nga LDK-ja? Hyrije Dobrunaj.

Hyri Dobrunaj

I nderuari kryetar i komunës, të nderuar drejtorë, të nderuar koleg e asambleist sa i përket raportit financiar, kësaj radhe po shumë pak kemi me diskutu. Sepse raporti financiar nuk është analitik, dhe në bazë të kësaj ne nuk mundemi me ditë absolutisht shpenzimet, kategoritë qysh janë të ndame unë besoj që ky raport është për facebook, për faqe me publiku, por jo për asamblenë,

sepse na jemi me analizu, sa i përket pyetjeve që i kemi bërë në KPF, drejtoresha e ceku disa mirëpo nuk foli për pyetjen më të rëndësishme, e cila është bërë dhe diskutuar në KPF, meqëse komuna jonë deri me këtë gjashtëmujorin e 1-rë ka pagu 4 milione e sa.. përmbarime. Me çka ka me funksionu komuna 6 mujorin tjetër. A kemi me pas hiç mundësi me diskutu për raportin financiar apo jo? Se në qoftë se nuk kemi .. kemi zero, zero për pagesa çka diskutojmë, plus kjo është paralajmërimi që na ju kemi dhënë përpara që në këtë fundvit keni me rreziku dhe për paga e meditje me i kry. Kjo është realiteti, nuk du të flasë më shumë për këtë raport, sepse nuk ia vlen me të vërtetë koleg më vjen keq, unë e kisha dashtë sinqerisht edhe nëse e kam ndonjëherë ndonjë kritikë është diçka që duhet me bo. Po unë kisha dashur që ky raport me qenë më i mirë për komunën e Deçanit. Ky është raporti më i keq që kem pas ndonjëher 4 milion i kemi pagu veç... gjykata, pa e dit fare ndëshkimet e sa i ka pasur për këto 4 milion, edhe ato duhet me qenë ..nëse janë 0,4 ose 0,6 mundeni me llogaritë vetë dhe kështu që më vjen shumë keq që ky raport është më i keqi ndonjëherë. Faleminderit.

Hajdar Sutaj

Nga Vetvendosja Faton Selmanaj

Faton Selmanaj

Përshëndetje për të gjithë, një pjesë që e kemi diskutuar edhe në komisionin për politikë e financa veç i tha drejtoresha, as aty nuk jemi pajtu me këtë formë të raportit, sepse është i mangët, si me than janë vetëm vlera të përmbledhura, por jo raport analitik po ashtu kemi pasur paqartësi në disa emërtime disa..kodeve. Për cilat për një pjesë kemi marrë përgjigje për një pjesë nuk kemi marrë përgjigje mbi të gjitha, ky raport tregon se ka një keq menaxhim dhe keq planifikim fillimisht të paras publike. Sepse po të merren 4.073.000 euro është vlerë jashtëzakonisht e madhe të mirrën përmes përmbaruesit, nuk isha lëshuar në detaje të tjera fillimisht Faleminderit për fjalën dhe një herë kryesus mundesh me kalu te kolegët tjerë po pastaj kam edhe diçka për të diskutuar.

Hajdar Sutaj

Faleminderit Faton. Zotri Mon Selmanaj.

Mon Selmanaj

Faleminderit kryesues përshëndetje kryetar, përshëndetje për të gjithë ju të pranishëm. Edhe une si para folësit nuk pajtohna me formën e ardhjes së këtij raporti, kështu siq është dhe nuk pajtohna me drejtoreshën që thotë që mund ta gjeni në web faqen e komunës raportin detal, sepse ne për tu përgatitur për seancën ne na duhet materiali 1 javë 7 dite pune përpara që ta ta kemi prezent në mënyrë që të jemi sa më të përgatitur për seancën e radhës. Ky raport i ardhur në këtë formë unë kam pasur vërtetë edhe në muajin e kaluar në raportin 3 mujor sepse është i papërshtatshëm për ta analizuar dhe për të konkluduar në fund për të gjeturat e këtij raporti dhe shpresoj që raporti nëntëmujor dhe raporti i fundvitit të na vi në formën e mëparshme, siç ka qenë, sepse aty janë të gjitha mundësitë që ne si kuvend dhe anëtarët e kuvendit ti analizojm me detaje të gjitha shpenzimet e bëra në këto raporte ju faleminderit.

Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë, siç e dini që pas çdo diskutuesi në çdo kohë mundet me kërk fjalën dhe drejtoresha për buxhet dhe financa apo kryetari e hapi diskutimin për asambleistët.

E ka kërk fjalën Vatton Istrefi

Vatan Istrefaj

Faleminderit për fjalën kryesues, përshëndetje për të gjithë.

Atëher un dua të jem sa më i shkurt në raportin financiar kam 1 pyetje për kryetarin e komunës, është 1 kod buxhetor që është i cekur pothuajse në të gjitha dikasteret e komunës, kompensimi përfaqësimit brenda vendit. Pra edhe nëse marrim shifra totale e kap rreth 50.000 euro, çfarë është kjo? Çfarë është paguar me këto para kompensim i përfaqësimit brenda vendit? Faleminderit.

Hajdar Sutaj

Faleminderit, Blinera Lokaj.

Blinera Lokaj

Faleminderit kryesus unë kam një pyetje me cilin kod saktësisht janë paguar drekat zyrtare, pasi që dyshimet tona janë se mund të jenë të kamufluara nëpër ndonjë kod tjetër, meqenëse askund nuk figuron përshkrimi drekë zyrtare.

Hajdar Sutaj

Faleminderit, Miftar Ahmetxhekaj

Miftar Ahmetxhekaj

Faleminderit shumë kryesues nuk dua ta zgjas shumë du prej të fundit ata qa e potencioj drejtoresha e financave e 4 milion euro permbarusi, dhe tha nuk e kam kalkulu pjesën unë po e quaj të penalltisë, ose penalizimin nëse nuk gaboj nëse nuk gaboj mund të jem i gabum ligji për marrëdhëniet detyrimore, nëse pagesat janë më të vonshme se sa 1 vitë kamata e nderume drejtoreshë është diku 8% e ke shumë të thjesht kalkulojë 4 milionësh për 8% e she ose e vlerëson vetë se ku keni ngecur. Kryetar ju kam drejtuar me 1 pyetje dhe sot dua ta bëj pyetjen përherë të dytë Momentin që po flasim ju jeni zyrtar kryesor administrativ. Sa keni detyrime? sa keni borxh momentin që po flasim sa ka borxh buxheti i komunës? Nga momenti që po flasim.

Hajdar Sutaj

Faleminderit Miftar, dikush tjetër Sylë Balaj.

Sylë Balaj

Atëher përshëndetje për të gjithë e kamë shkurt edhe unë. Drejtorja për buxhet dhe financa ka paguar 54.000 euro vetëm për furnizim për zyret qfar janë këto pagesa se e kam të paqartë faleminderit. Faleminderit shumë, Orges Tafilaj.

Orges Tafilaj

Faleminderit kryesur, të nderuar kolegë fillimisht problematika u cekë janë parat e qytetarëve që po merren me vendime gjyqësore dhe përmbarimore. Jemi të prirur sa herë që diskutojmë, për me diskutu për obligimet që na rrjedhin si rrjedhojë e 1 vendimi qeveritar, megjithatë në bazë raportit që na ke sjellë drejtoreshë është këto pagesat e kryera përmes vendimeve gjyqësore janë dyfishi i atyre të arsimit që po merren nga arsimit. Pajtohem me parafolësin që është shumë e rëndësishme të dihet për momentin sa ka borxh komuna, edhe të njëjtën kohë kur përmenden vlera të tilla që e kalojnë 4 milionëshin, duhet të dimë për cilat pagesa janë kryer? Unë e kam parë

raportin analitik financiar 3 mujorshit, megjithatë kjo vlerë është rritur në kohën e fundit dhe po presim tash sod me pa, megjithatë munges të saj kish qenë mirë kryetar ose nëse delegon te drejtoresha me na u përgjigj për qfarë janë marrë përgjegjësi këto vlera, sepse janë vlera të mdhaja. Tjetra që shohim janë shpenzime utilitare prapë të pagume bllok, dhe janë vlera të mdhaja ku shihen kështu. Megjithatë prapë edhe për këtu është mirë të kemi sqarime për cilën periudhë janë kryer, sepse po e zëm shpenzimet telefonike vlera enorme, unë nuk besoj që janë shpenzime që janë krijuar për 6 muaj. Është mirë me ditë për cilën periudhë janë kryer këto pagesa, rrjedhimisht siç e kamë cekë, sa herë që kemi diskutu për raporte financiare, pikërisht këto raporte financiare dhe mënyra e operimit me buxhet ndikon edhe në opinionin pastaj të auditorit. Fatkeqësisht me këto që po shohim prap edhe vitin e ardhshëm do kemi 1 raport të auditorit të njëjtë faleminderit.

Hajdar Sutaj

Faleminderit Orges dikush tjetër. Me qenëse nuk ka të lajmëruar të tjerë për fjalë Drejtoreshë, nëse ke nevojë për ndonjë.. Kryetar ose ju ose drejtoresha, në se keni nevojë, kryetari i komunës zotri Bashkim Ramosaj e ka fjalën faleminderit.

Bashkim Ramosaj

Përshëndetje për të gjithë juve.

Po mundona me qenë edhe unë i shkurt dhe po mundohem me qenë sa ma sqarus po filloj prej pyetjes më interesante që u bë për herën e dytë.. qe po thot për herë të dytë është bërë janë dy lloje borxhësh që komuna i ka përsipër. Një borxh e ka të trashëguar prej kontratave që janë në funksion e sipër, dhe po ashtu është një borxh i cili projektohet këtë vit që janë kontrata të lidhura në bashkëpunim me ministritë e linjës, ku ti duhet me pas njëfar zotësie që me marr kët buxhet. Borxhi që rrjedh prej kontratave që janë nënshkruar vitin e kaluar që po punohet këtë vitë e kalon shifrën 870.000 euro saktësisht është 877.000 euro totali. E kurse borxhi ndaj kësaj kategorisë që vjen si pasojë e kontratës kolektive, nuk është që dihet. Është një diçka me të cilën ne nuk jemi pajtuar anjëher si kryetar të komunav po pak rëndësi ka kjo, sepse kjo po ekzekutohet domethan komuna e Deqanit sanksionohet më shumë se 2 milionë euro vetëm prej kontratës kolektive, që i bie më shumë se gjysma 60% e buxhetit për investime kapitale. Dhe kjo punë nuk ka të ndalur deri në fund të vitit mundemi me pas përmbarime të natyrës së njëjtë, kategorisë kontrata kolektive edhe më shumë dhe që po bëhet njëfar riformatimi komplet i buxhetit i cili kish me na japë mundësinë për mos me u ndal në punë të tona, mirë po as edhe në pagesa që i kemi si detyrim. Të jemi të qartë, po mos të ishte pasoja si rrjedhojë e 1 vendimi të kontratës kolektive ne ishim tepër komode, ishim ma me standard dhe kishim me kry punë ndoshta edhe më shumë. Obligimet vetëm këtë vit që komuna ka hy në këto obligime me nënshkrime të një kontrate dhe 3 kontrata të tjera që priten me përfundu procedurat e prokurimit publik në komunën e Deqanit, bashkëpunim me mekanizmat institucional të qeverisë e shtinë në rrugëtim dikun që është 12 milion euro investim.

Hajdar Sutaj

Takime ku kemi mbet jemi te pika 6. Shqyrtim i draft planit zhvillimor për arsim 2024-2026 Në emer të AAK-s ja jap fjalën zotri Arian Dobraj, Arjan Dobraj e ka fjalën faleminderit. Urdhëro zotri Arjan, faleminderit nuk ka diçka per te shtuar vetem i uron dhe i pergezoon kolegt ...Nga LDK-ja?

Hyri Dobrunaj

Sa i përket planit zhvillimor për arsim, të komunës së deçanit i kemi diskutu edhe ne kpf i përgëzojmë grupin punues për hartimin e atij ..aj është draft ende nuk është plan, mirëpo atij drafti i kemi dhënë sugjerimet tona sa i përket atij plani në komitet për politikë e financa edhe pse nuk më duken të plota që janë ardhur ne listën, mirëpo edhe aty e kemi dhënë si shqetësim se asnjë plan nuk mundet me u zhvillu. nëse nuk ka mbështetje buxhetore, komuna e deçanit ka 0 për këtë 6 mujor, kështu që i uroj shumë fat e suksese.

Hajdar Sutaj

Falemnderit kolege nga Vetvendosja Orges Tafilaj.

Orges Tafilaj

Falemnderit kryesues të nderuar koleg, përgëzime për punën që ka bërë komisioni mbi të gjitha, prej që jam në asamble është hera e parë që kemi 1 plan zhvillimor të arsimit, po krahasu me plane tjera na ka ardhur pa gabime drejtshkrimore kështu që përgëzime, në lidhje me ambiente të përshtatshme arsimore. Ne shkollën e fshatit Lëbushë duke ju falënderuar... janë vendosur kamerat, u vendosën ulëset dhe shportat e mbeturinave duke falënderuar higjienën dhe kryeshefin Loshajt. Mirëpo ka nevojë për intervenime shtesë që besoj duhet meqëse pashë shkolla e fshatit Isniq nuk ish marrë parasysh fare paralelja në Lëbushë. Besoj unë duhet shtohet 1 fushë multisportive kemi pas kërkesë këtu për 2 portat të paktën, po kalon gati 1 vit dhe nuk jam vendos të njëjtën kohë shkolla ka nevojë për 1 kënd lojërash që ka hapësirë të mjaftueshme për ta bërë dhe në aspektin e zhvillimit mësimor shkolla nuk ka asnjë printer. Nuk ka 1 kompjuter si duhet dhe mësimdhënësit detyrohen që printimet e materialeve ti bëjnë shkollën amë në Isniq. Besoj, është shumë urgjente pajisja e shkollës me 1 kompjuter dhe nje printer. E përmendi ma herët drejtoresha qeshtjen me bursa, u besoj që është e rëndësishme të merret parasysh edhe për nxënësit meritator. T'ju ndahen bursa po t'ju ndahen bursa para se të jetë afati i regjistrimi të tyre, në mënyrë që këta kur të shkojnë në vitin e 1-rë të kenë një mbështetje sado të vogël financiare. Falemnderit.

Hajdar Sutaj

Falemnderit Orges. Mon Selmanaj

Mon Selmanaj

Kryesues une nuk kam diçka me shtu vetëm i japin mbështetje këtij draftplani, por shpresoj se ditëve në vijim gjatë diskutimit publik do të japim edhe ne kontributin tonë këtij drafti falemnderit.

Hajdar Sutaj

Flameniderit shumë dikush tjetër, Miftar Ahmetxhekaj..Faton Selmanaj

Miftar Ahmetxhekaj

Falemnderit shumë kryesuesi gjithashtu edhe unë sikur parafolësit realisht ju gëzohen dokumenteve të mira, megjithatë i kam 2 - 3 dilema ose pyetje më saktësisht. Në faqen 24 e keni ndërtimi i 3 çerdheve të reja Drenoc, Strells i epërm Gramaqel. Adaptimi i 2 çerdheve Isniq edhe Irzniq me sa di une para 2 seanca na ne Isniq kemi ndonjë nje parcelë kadastrale për ndërtimin e 1

çerdhe të re. Nëse ka mundësi dikush te ma spjegoj çka nënkupton adaptimi, edhe pse është larguar si ndertim i ri. Prap na kthehemi ne ata te kalumën që ka probleme në planifikim ose atëher është bërë gabim ose tash. Faqe 29 prapë flitet për rrethoja të shkollës së Isniqit. Projekt për ti riparuar dhe ngjyrosur, projekt i cili veq ka filluar se gjysma e tyre kanë përfunduar, prap gabim për vlerësimin tim ne projektim ose ka filluar ose është dasht te pritet me projekt. Faqe 34 këtu mos të keqkuptohem është... parashihet në investim në shkollën e Vokshit. Unë absolute i gëzohem secilit investim.. është dashtë më mirë të shikohet mundësia se edhe ashtu ka rënie të nxënësve në atë shkollë edhe ashtu ka... une sa kom informat ka klasë qe i ka veq 2 nxenes ne klas.. të shikohet mundësia e bartjes në 1 shkollë tjetër amë siç është Dranoci dhe mos bëni investime të kota ku ndoshta pas disa vite mund të mbyllet mos keqkuptohem këtë fushë. I gëzohem secilit investime dhe për fund ne faqen 34 kur i keni paraparë kërcënimet te cilat mund te ket arsimi 1 prej tyre është largimi i mësimdhënësve une po e ruaj të drejtën e vetes 1 konstatim timin se nje prej kërcënimeve është dhe punësimet politike, të cilat janë duke ndodhurë dhe mund ta them kur me argumente dhe jo më larg sesa para disa ditëve në shkollën Isniqit. Arsyeja ose çka mund ti paraprijm nje punësimi politik është mundësia e largimit kuadrave dhe tjetra është mundësia e kyçjes në sistem të njerëzve, jokompetentë dhe të njerzëve, të cilët realisht nuk janë profesional në fushat për të cilën ata punësohen, faleminderit shumë.

Hajdar Sutaj

Falemnderit. Fatoni pastaj Orgesi

Faton Selmanaj

Falemnderit kryesues

Unë kontributin tim e kam dhënë edhe në komisionin për politikë e financa po ndashta edhe 1 herë me cekë këtu fillimisht lidhur me çerdhet. Mendoj po ashtu njëjt si kolegu që në Isniq përderisa është nda nje parcell, është dasht të ndërtohet 1 çerdhe e re. Dhe mendoj që edhe drejtori ka fakte dhe argumente të mjaftueshme me arsyetu para ministries ndërtimin e një qerdhe të re në këtë lokalitet. Edhe e 2-ta qa po du me shtu është e dimë të gjithë që keni mungesë të stafit arsimor në shumë shkolla, me theks të veçantë në landën e matematikës fizikës e ndonjë landë tjetër propozimi im kishte me qenë që të planifikohen bursa me vlere më të larta por këto 2 fusha në veçanti. Falemnderit

Hajdar Sutaj

Falemnderit Faton. Vatan Istrefaj e ka fjalen

Vatan Istrefaj

Falemnderit kryesues.

Por ne si anëtarë të komitetit politik dhe financa kemi diskutuar atë ditë gjatë mbajtjes së seancës mjaft. Kështu që më ka mbetur vetëm 1 pyetje po ashtu drejtor rreth qerdhes në fshatin Strells i epërm , pasi lokacioni është caktuar. Kur mendoni se do të fillon?

Hajdar Sutaj

Më fal veç 1 minut a kemi ndonje penges a? Ok mundsishtë edhe një here

Vatan Istrefaj

Po drejtor edhe nje herë po e bëj pyetjen rreth qerdhes në fshatin Strellc i epërm, ku mendoni se do të fillojnë punimet dhe investimet nga kush është? Falemnderit

Hajdar Sutaj

Faleminderit dikush tjetër a ka diçka me shtu? Drejtor fjala për juve, drejtori Besnik Vulaj e ka fjalën.

Besnik Hulaj

Atëher përshëndetje për të gjith filloj prej Orgesit për në shkollë. Kënd lojrash kemi parapa sikurse ne krejt shkollat tjera që kanë mungesë të këtyre këndëve, kemi fillu me disa shkolla duke i pregaditur edhe dokumentat per fillimin e ndertimit te kendeve te lojerave te bursat...një pyetje e pata për bursat, a po po mfal! na e kemi nxjerrë bashkarisht edhe ju edhe ne gjith asambleist dhe kemi nxjerrë 1 rregullore që parashihet ndarja e si bëhet ndarja e bursave e shumën e din je kon pjes e komisionit, e kemi ngrit nga 250 450 me mundësi që kemi pas bashkëbisedim me kryetarin dhe me drejtoreshen e financave, 400 mfal edhe e kemi cek që në bazë të buxhetit dhe mundësive financiare të ngritet prap, po ashtu kemi lanë edhe në rregullore po kaloj te Myftar Ahmetgjakaj për ndërtimin e çerdheve në Isniq.

Na fillimisht e kemi ndarë një parcelë këtu në asamble për ndërtimin e çerdhes së re i kemi dërgu te gjitha dokumentat e nevojshme në ministrinë e arsimit në Prishtinë, mirëpo sipas disa statistikave qe i ka bër UNICEF.. nivel kosove jo vetëm Deqan, shkolla e Isniqit është e parapame 750 nxënës, ndërsa në shkollën janë 350 nxanca edhe sipas tyne na kanë kthy negativ kanë kërku me bo adoptim mbrenda objektit shkollor ka hapësir të mjaftueshme edhe na kanë kthy negative për ndërtimin e çerdhes së re domethan kan me bo qerdhe te adaptume, komplet projektimin e ndërtimin edhe ndryshimet se duhet me pasë 1 hymje te veqant i bën ministria me projektet tona qe i ka atje. Ndërsa ne planin zhvillimor komunal, ne kemi parapar edhe rinovimin e rrethojës, por edhe lyrjen e rrethojes. E gjitha këto që janë parapa ne planin zhvillimor komunal kanë ardhur nga drejtorat e shkollave kemi pasur konsultim direkte me drejtorat e shkollave e mira është se ke pas mundësi me hy ma herët e kemi hy ma herët. Është 1 plus edhe për neve dhe 1 plan i realizueshëm që realizohet ne te ardhmen ne planin zhvillimor. Ndërsa sa i përket Vokshit nuk jemi për me mbyll shkollen jo..tha i ka 2 nxanca nje klas i gzona që ka 2 se kemi për shembull problem kryesor kemi me shkollë buzë. Shkollen ...kemi. Kemi shumë pak nxënës, per fat te keq eshte shkoll e kombinume .. nuk është shkoll e kombinume eshte me klas. Po problem kemi me banorët ...krejt mundesit i kemi edhe si komun me i dergu ne shkolla tjera po pajtimin nuk e kemi gjetur asnjher me banoret. Te largimi i mësimdhënësve, ne e kemi e paraparë ne te ardhmen që eshte tu ra numri i nxansave vazhdimisht ka me pas tepriçë teknologjike sa i përket mesimdhënësve, shkruan edhe në kontratë, mirëpo të gjith këta mësimdhënës do të sistemohen gradualisht dhe nëse neve një mësimdhëns na rrezikohet për normë, konkurset, pensionimet apo largimet qe po bëhen tashmë me dëshirë, pa paralajmërim, po dalin jashtë dhe ne nuk hapin konkurse shkak të sistemit normativ e plot per mësimdhënës. Shkolla në Voksh eshte parapa prej shkolles amë me u renovu ne banjo kemi intervenu si ne vitin e kalum..i kemi renovu te gjitha banjot me ka mbet vetem kelqerosja e objektit me u bo..punët tjera kan perfunduar te Faton Selmanaj siq ja spjegova Miftarit gjitha dokumentet i kam derguar per me bo shkollen e re e kem nda edhe parcellen..qerdhen eshte e pa mundur ne bazë të statistikav qe i ka bërë UNICEFI te cilat i posedon ministria e arsimit. I kemi dorëzu si dokumentacion, i ka edhe ministrja, i kanë edhe menagjeret e projekteve që në ministri na kanë kthy negativ, kanë kërkuar që të bëhet adoptim. Edhe ky është investim nga qeveria, ke cek se kemi mungesë të stafit, nuk kemi mungesë të stafit po mungesë të kuadrave... Dhe sa i përket matematikës, fizikës dhe artit mirëpo në rregullore kemi parapa se edhe me noten me te ulet per me marr nje burs e ato jan mundesit tona ..po ne te njejten kohë këta të gjithë nëse e zgjedhin atë drejtim subvencionohen edhe nga ministria se janë

mungesës deficitar, jo vetëm të na krejt Kosovën. Të gjitha komunat kanë probleme këto kategori, e investimet i bën ministria me kërkesën tonë. Fillimisht e kemi caktuar si parcelë mes të shkollës vjetër edhe palestrës sportive mirëpo për shkak se është në mbrojtje shkolla e vjetër nuk na kanë lejuar 50 metra me ju afru në bashkëbisedim disa qytetare dhe me drejtorin e shkollës e kemi paraparë që të ndërtohet te fusha e sportit lart sepse kishim disa parcela të tjera që kanë qenë në Strells.. Po ishin me kontestet gjyqësore dhe nuk na kanë lejuar, duhet me qenë pllaci pa konteste, kanë afuar disa banorë, disa parcella që kishin të tyre po edhe ato ishin konteste dhe skemi mujt e vetmja shanc ka mbet te fusha sportive. E sa i përket fillimit të ndërtimit edhe ne Strellc edhe tjerave ne si komunë, drejtori i arsimit te gjitha dokumentacionet i kemi përcjellur në ministri, projektet janë të kryera qe na kanë çu për 60 nxenes a 80 nxënës sikurse është duke u bërë për 120 nxenes ne Calabregmirëpo gjithçka varet tash prej ministris se ministria e bën projektimin, i ndan buxhetin, e ndërton i bën pranimit teknik na vetëm që shkojmë bashkë me to dhe e prej atë shirit plus kërkesën e kemi bërë na si komune për nevojat tona, mirëpo ndërtimin e bën komplet ministria nese dikujt i kam mbet borq ndonje pyetje ose diçka.

Hajdar Sutaj

Faleminderit Drejtor

Orges Tafilaj fjalën pastaj Miftari

Orges Tafilaj

Faleminderit kryesues, drejtor kemi pasë fatin me qenë edhe në komision për hartimin e rregullores dhe për ndarjen e bursave. Ajo që ceka është që mendoj që ne duhet ta përditësojmë atë rregullore e përmende edhe vet kemi mungesë kuadrave, besoj ne duhet themelojmë komision për përditësim të asaj rregullore dhe të merren parasysh maturantët që kanë pas sukses të mirë në shkollë, maturantët që nëpër gara na kanë zbardhur fytyrën dhe po ashtu edhe ata që kanë kaluar testin kombëtar me rezultate të larta. Nëse potencialisht X maturanti zgjedh drejtime që ne i kemi deficit, besoj që duhet të përkrahen. Unë besoj që do ishte mirë të merret parasysh edhe ky element, Faleminderit.

Hajdar Sutaj

Faleminderit Miftar Ahmetgjekaj, a do mu përgjigj menjëher Besniku Vulaj e ka fjalën Drejtori.

Besnik Hulaj

Faleminderit Orges edhe njëher nuk është e mirë po na kemi cek edhe në rregullore që duhet me u pa perfundimi i vitit, dëmthën duhet me perfundu viti akademik për me i nda bursat po ashtu mundet me u regjistru krejt kollaj dikush se ne e dimë si matematikë fizikë kimi dhe fakulltet teknik nuk ki as test pranimi në këto fakultete se ka munges te studenteve qe regjistrohen Ndoshta na del ndonje keqkuptim gjatë rrugës që me regjistru me nda ne ni burs edhe mos me bo kurgja me atë pun atëher i bjen si keqperdorim i pares publike ne mundemi me u bashku siq e kemi votuar ata ne mund të bëjm edhe ndryshime bashkarisht, sepse asamblesë ka dal edhe ajo rregullore, po na prap se prap këtu jemi bashkë jemi.

Hajdar Sutaj

Faleminderit, Miftar Ahmetgjekaj

Miftar Ahmetgjekaj

Drejtor me plotësu pak vetëveten ndoshta dhe pak me pas kujdes në asnjë mënyrë nuk propozova

të mbyllen shkollat te i ikim pak zhargonit. E 2-ta demokracia edhe ligji 1 2 kategori edhe centralizimi dhe decentralizimi, e cila i bjen bon edhe e para bon edhe e dyta. Nëse eventualisht ka kosto të lartë financiare kjo ke ideja jeme, a ka si mundësi pa dashtë se as kom mandat me bo diçka ..po thoni qe ka kosto të madhe financiare dhe parashihet prapë më pas kosto është si mundësi për të ikjes koston dhe bëhet akomodimi diku tjetër dhe këtu ishte ideja jo për të mbyllur në asnjë mënyr, faleminderit

Hajdar Sutaj

Po drejtori Besnik Vulaj e ka fjalën.

Besnik Hulaj

Më fal doshta jemi keqkuptuar edhe në biseda po nuk ka kosto të madhe financiare vetëm suvatime, se të tjerat kanë perfunduar të gjitha. Edhe për fat mirë gjitha investimet dhe renovimet bëhen edhe me donatorët të jashtme te mbrendshëme me bugjet të komunës dhe gjithçka që kemi cekë e kemi parë që mund të mbulojmë. E sa realizohet, ne kemi me qenë prap këtu dhe ke me pa rrjedhshmeri realizimin e tyre se e kemi cekë edhe vit per vit, një pjesë e madhe e tyre vetëm kan fillu për shembull sikur i kemi trotuaret që kemi tash te shkolla Belek kemi kodrali shkollën me te dy anët që kemi vazhdu eshte ne Glloxhan dëmethen gjitha jan parapa dëmethen gjitha jan parapa si siguri në shkolla për me shku nxënësit me kollaj nëpër shkolla e 1 pjesë e tyre kanë fillue jan duke implement.. çka kam hequr pak keq me digjitalizim kem hjek pak ma shum, po ministria ka parapa mrena 3 vjete mu bo digjitalizimi i te gjitha shkollave 7 prej tyre janë kryer.

Hajdar Sutaj

Hyrija e ka fjalën..Hyrije Dobrunaj

Hyri Dobrunaj

U fol edhe për rregulloren e bursave, drejtori i tha që e kemi votu të gjithë së bashku. Po është e vërtetë që e kemi votu, sepse ne e mbështesim secilën ndihmë e cila ju ofrohet nxënësve ose studentëve. Mirëpo le të jem të qartë se na edhe atëherë edhe sot po i japim 1 alternativë tjetër për komunën e deçanit. Jo vetëm që keni kuadrot deficitare është e nevojshme dhe arsyeshme gjithmonë me ju dhan bursa mujore e jo nifarë lloj ma mirë është me qujt subvencion. Nëse i jepni herë në vit sesa bursa nuk është bursë faktikisht, duhet me e pas të qartë që nuk është bursë është subvencion ose ndihmë për nxënës e studentë. Ne kemi kërku edhe atëherë kërkojmë edhe sot mesim aty që student nxënësia duhet të marrin bursën mujore, ka mënyra si sanksionohen nëse keqpërdorin nuk vazhdojnë sepse bëhet kontrata. Në fillim kur e marrin bursën rregullorja, patjetër uroj e shpresoj që shumë shpejt duhet me u ndryshu edhe të gjithë studentët që meritojnë me marrë bursë përmuajshme Deçanit, sepse komuna e deçanit nese mirë planifikon, ka mundësi buxhetore me i mbështet të gjithë studentët e komunës tonë faleminderit.

Hajdar Sutaj

Falemnderit kolege, a ke diçka me shtu kët pikë ..në rregull Teuta Neziraj, Faton ti je lajmëruar përpara për fjalë urdhëro ne rregull Teuta Neziraj fillimisht

Teuta Neziraj

Atëherë përshëndetje unë deshta veç me ngrit 1 çështje që seanca është duke u transmetuar pa zë, po na lajmërojn qytetarët që nuk po të dëgjohet asigjë

Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë, besoj e rregullojn tash ...vazhdon Fatoni shikone testone ..a është lëshuar zëri, a ka dikush tjetër para se me fol Fatoni jo paska.. në rregull është vazhdo Faton Selmanaj.

Faton Selmanaj

Faleminderit kryesues..Drejtor po e kam të qart që edhe Ministria ndanë bursa, por përderisa keni mungesë të kuadrit e vlersoj që ta merrni pak me seriozisht edhe keto 3 fusha realisht të caktume, perveq që te ndani bursa të veçanta, ta rritni edhe atë vlerë të bursës.

Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë, dikush tjetër.

Atëherë ne tu e pas parasysh drejtor nëse keni mundësi rekomandime të kolegëve me i marrë po ashtu edhe me i pranë dhe gjatë fazës që janë në diskutim publik edhe gjatë debatit publik, edhe pastaj vjen seancën e ardhshme që do ta kemi draftin përfundimtar dhe pastaj me votu, ju kisha lut që ti japim mbështetje që me vazhdu në hapat e mëtutjeshme këtij draft plani zhvillimor për arsim 2024-2027

Ku është për?

A ka kundër?

A ka abstenim?

Konstatoj se në mënyrë unanime, kuvendi komunal i ka hapë mundësi shqyrtimit të këtij draft plani zhvillimor të arsimit për vitin 2024-2027, jemi te pika e 7-të koleg, që gjësisht i bjen pika e 5. Rialokimi mjeteve financiare në kategorinë e investimeve kapitale, në të cilat e keni të bashkangjitur edhe shkresën edhe materialin.

Fillimisht ja kisha kalu fjalën drejtoreshës për buxhet dhe financa zonjës Dafina Cocaj e pastaj hapim diskutimin.

Drejtoresh fjala për juve.

Dafina Cocaj

Faleminderit kryesues përshendetje dhe nje herë te bashkangjitur e keni kerkesen e Kryetarit dhe drejtorisë për buxhet dhe financa për rialokimin e mjeteve të projektit planifikuar ndërtimin e objektit të ri të komunës. Mirëpo për shkaqe teknike nuk kemi mujt këtë vit me fillu edhe mjetet janë nga të hyrat vetanake, e janë 150.000 euro, po kërkojmë që me i rialoku ne 2 projekte ekzistuese e projektet ekzistuese janë sipas kontratave që i keni bashkangjitur edhe kërkesës së menaxherit të kontratav, njëra është inventari në koloninë e artistëve dhe tjetra është ndërtimi i 4 urave që çon për në Shkodol dhe parkun Isniq. Te kolonia e artistëve është projekt i komunës, i cili vjet ka filluar vlera totale e tij eshte 129.000 euro, e kemi mbërri me i pagu 50.000 euro, kompania është e gatshme me punu nëse na kemi mjete financiare, për këtë arsye edhe po kërkojmë me aprovu që edhe 79.000 euro me ja Ç'it tani kompanisë për punët që i kryejnë edhe mu kry si projekt komplet edhe mu bë pranimi teknik, ndërsa te ndërtimi i 4 urav të çon për në Shkodol dhe ndërtimi i parkut Isniqit, është tender edhe ky ka fillu vitin e kalum ka qenë memorandum me ministrinë e pushtetit lokal e në memorandum obligimet tona kanë qenë 80.000 euro nga ministria, pjesa tjetër, komuna 80-80 na ka ra mirëpo procedurat e tenderimit të projektit kanë shkuar 2 herë në ritenderim edhe për shkak të motit të keq andej nga bjeshkt vjet kompania nuk ka arritur me punu, ka punu vetëm për vlerën 20.000 euro i ka marrë 20.000 euro dhe pjesa tjetër komplet ka mbet per komunën. 42.000 i ka marrë kompania këtë vit, mirëpo ata përderisa janë të gatshëm me punu ende na po kërkojmë që edhe 40.000 euro mi siguru që me punu ata dhe mi

mar sivjet. Pjesa tjetër atëher çka mbetet me e vazhdu vitin tjetër, sepse total kontrata është 172.000 euro. Faleminderit për ndëgjim shpresoj që e votoni

Hajdar Sutaj

Drejtoresh faleminderit edhe për sqarimet, prej grupit AAK-s Arjan Dobraj.

Arjan Dobraj

Faleminderit kryesues. faleminderit drejtoreshës për sqarimin eshte normale nëse kërkohet që shuma caktuar me shku për projekte të cilat kompanitë kanë shprehur. Gatishmërinë që me u perfundu mu kry këtë vit, por vetëm diçka nuk e kuptova te shifrat sepse 40.000..plus 79.358 euro bien 119.000 atëherë shifra më lartë është përmendur në kodin për 150.000 euro nga të hyrat vetanake. Po. Sa kanë nevojë për me kry projektin. Nuk kemi diçka tjetër, per te shtuar falënderim.

Hajdar Sutaj

Falemnderit nga LDK-ja? Hyrije Dobrunaj

Hyri Dobrunaj

Ne i kemi dhënë vizë ketyre te barturave vetanake mirëpo si grup parlamentare e diskutum kemi edhe prej Isniqit që nuk e dim lokacionin e atij parku ne Isqniq ish kan mir me na e saqru dikush, me dit ku eshte lokacioni i atij parku.

Hajdar Sutaj

Faleminderit shum. Drejtori Ramë Melaj e ka fjalën për me e dhanë përgjigjen, cilën e pyeti kolegia?

Ramë Melaj

Përshëndetje të nderuar.

Momentin kur është bër memorandiumi i bashkpunimit mes minsitris dhe administrimit te pushtetit lokal dhe komunës ka qenë kërkesë e ministrit që të bëhet edhe një park dikund.. në Isqniq e ka cek, dhe ne kemi kshyr ku me gjet atë hapsirë kemi vendos qe ajo hapsir te behet te kulla e Tahir Sylaj është një kull që është e mbrojtur prej monumenteve, është nje hapsir aty perreth kullës qe nuk është trajtuar mirë..aty është menduar te ndërtohet aj park nese keni parasysh se ku gjindet ajo kull besoj qe Miftari edhe Sylja e din ..munden me ju tregu a e dini edhe ju ku është? Faleminderit shumë.

Hajdar Sutaj

Falemnderit shumë, Prej Vetvendosjes Faton Selmanaj

Faton Selmanaj

Faleminderit kryesues.

Edhe ne si grup e përkrahim këtë bartje edhe po më vjen mirë edhe prej drejtorit që fokusin e ka kthi pak nga Isniqi edhe ka bjeshkët dhe ka rrafshi me disa projekte kështu se keni pasë lane pasë dore e vlerësoj edhe unë si qytetar përkrahjen e këtyre projekteve.

Hajdar Sutaj

Po drejtori Ram Melaj e ka fjalën, nëse ka mundësi Yll me ndez mikrofonin.

Ramë Melaj

Faleminderit shumë por nuk është vetë për Isnqi ura, në atë pjesë shkojnë edhe prilep dhe disa fshatra tjera. Se ashtu është gjeografia, mendoj që është bërë një punë jashtëzakonshme që sa kohë që aty kanë filluar njerëzit vullnetarisht me i ndertu ato ura me dru paramendo në këto kohë janë bërë urat nga betoni u zgjidh problemin njëher e përgjithmonë. Mendoj se është investim shumë i qëlluar, kështu që ta gëzojnë qytetarët e Deçanit, atë projekt aq mirë që është bërë.

Hajdar Sutaj

Falemnderit shumë, Zotëri Mon Selmanaj e ka fjalën?

Mon Selmanaj

Faleminderit Kryesues.

Disa dilema që i pata unë rreth këti realikimi të mjeteve të sqaroi në përgjigje drejtoresha e që i dha zotit Arjan. Mirëpo, në kodin që përmban shifrën 150.000 euro po teprojnë 30.000 euro. Kisha kërkuar nga ju drejtoreshë dhe nga drejtori i urbanizmit, zoti Melaj se këto mjete që mbesin diku 30.000 euro të ridestinoni në projektin e urës në fshatin Restovic, gjegjësisht bëhen 5 ura 4 në bjeshkë Roshkodol dhe 1 Restovic 5. Kish qenë shumë e drejt, shumë e drejtë që këto mjete të ridestinohen për atë projekt. Ju 2 drejtorët ju e dini që disa herë kanë qenë inxhinierët e lamisaktume kanë bërë vlerësimin kanë bërë Incizimet në terren kanë bërë paramasat dhe paralogaritë përparësisht dhe nuk e di a mjaftojnë këto mjete mirpo kish me qenë mirë mu në nisje ju faleminderit.

Hajdar Sutaj

Falemnderit shumë, drejtoresha Dafina Cacaj e ka fjalën.

Dafina Cacaj

Me gjithë qef e kishim bërë edhe e kishim vazhdu e me kon qe na lejohet, mirëpo me bërë projekt të ri tashti për këto 30.000 euro është më shumë se gjysma e vitit edhe janë procedura shumë të gjata për me nis projekt të ri rishikim buxheti nuk kemi pas. E me rialokim nuk e di, a na kalon që me nis si projekt i ri për këto po e shfrytëzoj kodet ekzistuese se është procedurë më e lehtë për me u nda mjetet me shfrytëzu kontratën e njëjtë nuk bën se me gjithë qef

Hajdar Sutaj

Falemnderit drejtoreshë, Blinera Lokaj e ka fjalën

Blinera Lokaj

Faleminderit kryesues.

Atëherë me qenë se jemi tek kjo pikë e rendit të ditës po e shfrytëzoj rastin të ndërlihem drejtor Ram Melaj me siguri e dinë që si është gjendja në rrugën që çon në bjeshkën Pllaçica e Vokshit. Janë gjithsej 5 ura në gjendje të mjerueshme për shkak të vjetërsisë së tyre. Këto ura së fundmi janë renovuar me 1 mobilizim të bashkëfshatarëve të regjionit të Vokshit, Junikut dhe Dobroshtit të cilët e kanë kryer punët e dorës, kurse financimin apo investimin me para dhe me materiale ka kryer kompania.

Hajdar Sutaj

Albesa Albesa m'kish thon qe pin len me foj jashta pike

Blinera Lokaj

Po ndërlihet me ura që... nesa ka mundsi me perfundu

Hajdar Sutaj

Po po veq eshte duke u folur per projektin aktual mundesh me diskutu te të ndryshmet ata veq deshta me i than ...mundet me vazhdu po e pata sa per ty

Blinera Lokaj

Drejtor si arsyetohet ky anashkalim nga ana e juaj. Meqenëse pra është dasht me u mobilizu vetë frekuentuesit e asaj bjeshke dhe mi kry vet ata. Ose në bazë të mundësive që keni buxhetore në dispozicion, a ka mundësi që në të ardhmen këto ura të rinovohen me beton në mënyrë që të rritet kapaciteti i tyre mbajtës si dhe të ofrohet 1 siguri më e madhe për frekuentuesit e Pllaqices së Vokshit? Faleminderit.

Hajdar Sutaj

Faleminderit shum Bliner jo për besë me konsiderat per Blineren me me pas qenë duke fol Albesa nuk e kish qu fjalen deri ne fund ..Po de po absolut që e bona ni bilanc.... kështu ju ka drejtuar drejtorit dhe ka përmend me emër Drejtori Ram Melaj e ka fjalen, jo me fal le ta perfundon nje her

Ramë Melaj

Fleminderit Kryesus.

Blinera faleminderit për këtë pyetje që ma bëre kështu eshte puna per keto 4 ura po du me livdu pak veten nashta nuk eshte marre diqka qe eshte kry dhe eshte vepru ato 4 ura i kom nxjerr bash une kendej ka Roshkodoli përmes miqve te nivelit qendror qe i kemi aty ata na kan perkrah, fatëkeqsisht skem mujt me shfrytzu krejt buxhetin po tash e falënderoj kryetarin e komunës ..edhe juve qe po e votoni tash ket menyre te rishqyrtimit besoj qe keni me votu bile ti Miftar ska dilema, qe do te thot kjo ka rrjedh ne përmes miqve që ne mundemi me bo ket pun barra kryesore i ka ra komunës për shkak procedurave që ne s'kemi mundur me i realizu qysh e tha edhe Drejtoresha. Sa i përket urave, sa i përket urav për pjesën ka zalli ru.. mundem me thon qe un aktivitetin tim si drejtor e kom bo..qa kom bo .. e kom bo projektin me shku deri ne Pllaqic te Vokshit por me shku edhe ka bjeshka e Dobroshit ato ura i kom pa i kom vizitu kan qen shum ne gjendje te keqe pasi jon riparu nuk i kam pa, e kom bo projektin edhe per asfaltim nuk eshte veq urat po komplet asfaltimi edhe ndertimi i urave vlera e keti projekti eshte dikun 11.000.000 euro që është hartuar nga 1 kompani, e cila na ka perkrahë në këtë projekt, e ka bërë inqizimin gjeodezik i ka bërë të gjitha detajet që parashihen muret mbrojtëse kanalet, e urat që i cek edhe ti, po ndertimin vetem te urave ju jeni ata qe mundeni buxhetin 2025 me parashiku me ndërto na si komun ose me gjetë ndonjë rrugë tjetër dika, si projekt e kemi te hartuar projektin është në zyrën time..vetem ta gjejm rrugen si me ardh deri te ajo.

Hajdar Sutaj

Falemnderit shum, Miftari pastaj Syla

Miftar Ahmetxhekaj

Faleminderit shumë.

Drejtor te përgesoj për punën me gjithatë për vullnetin, taksat janë të qytetarëve, absolut që

mbështesim. Veç një pyetje nuk e pash koston e këti parkut ne Isniq sa është kostoja ose se kuptova sakt unë .. edhe a jeni konsultu për shkak se bohët fjal në afërsi a ka me pas ky park pjes te ngritura a vetëm gjelbërim Nëse ka pjes të ngritura është pak problematike, puna e zonës mbrojtëse, aty ka qenë edhe 1 ide për 1 shtëpi të fshatit lagjja Tahir Sylaj dhe e di qe është një problematik se edhe 5 0 problematik per mu ba për shkak zonës mbrojtëse se përtej parcelës kadastrale i nevojiten zonës edhe 50metra, faleminderit.

Hajdar Sutaj

Falemnderit Miftar, Drejtori Ram Melaj e ka fjalën

Ramë Melaj

Miftar aj park nënkuptohet qe do të thot parku me u ndertu, nuk ka ndërtime të larta jan ndërtime të ulta ka trotuar është një kanal i ujitjes ka gjelbrim dhe ndriqim Ky është aj niveli qa ka mu zhvillu aty. Po vlera nese nuk gaboj... ndoshta mundem edhe me gabu ne vlera to vogla dikund te 14.000 euro vlera është e ati projekti që ka me u ndertu.

Hajdar Sutaj

Faleminderit Drejtor, Syl Balaj e ka fjalën

Sylë Balaj

Atëher përshëndetje për të gjithë

Edhe un ju përgëzoj për ndërtimin e 4 urave kanë qenë nevojë e madhe për bjeshkën e Rashkodolit.. mbështesë edhe parkun ne lagjen Tahir Sylaj kaq kam faleminderit.

Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë, kolegë e qesë në votim.

Kush është për?

A ka kundër?

A ka abstenim?

Konstatoj se ne menyre anonime anëtarët e kuvendit e kanë votu propozimin e kryetarit dhe drejtoreshës për buxhet dhe financa për rialokimin e mjeteve financiare në investime kapitale jemi te të ndryshmet. Siç e thashë, e kemi 1 rekomandim të cilën duhet ta voton kuvendi komunal që ka të bëjë për këmbimin e pronës, gjegjësisht të 1 rruge në Dashinoc, lagja Sadikaj, parashtrusi i kërkesës është Isuf Sadikaj, të cilën e kemi votuar më datën 28.04. E cila është e njëjta rrugë të njëjtin pronar, po vetëm që e kanë zhvendosur rrugën brenda pronës së vet e kërkohet prej kuvendit komunal, qe ti rekomandoj ekzekutivët ta bëjë vlerësimin financiar të 2 pronave. Nëse ka dikush diçka me dhanë ndonje, spjegim sa për sqarim edhe 1 herë është e njëjta, pronë është i njëjti pronar e ka pasur rrugën midis toke veq e ka vendos anash ne tokë te vet ne shtëpi te vet, edhe domethonë nuk eshte ber vlerësimi, por më thonë ashtu duhet me rekomandu si kuvend ekzekutivit që mu bë vlerësimi i kësaj prone.

Kush është për?

A ka kundër?

A ka abstenim? - jo

E kemi miratuar gjithashtu ju thom qe e keni pasur ni material për me diskutu te të ndryshmet, eshte propozim vendim i kryetarit për ndryshimet dhe plotësimet e vendimit të kuvendit të dates 03.09.2015 per dhenje ne shfrytëzim afatgjatë të pronës komunale, loti numër 4. Materialin e keni pasurë në email.

Po urdhëro Vatan

Vatan Istrefaj

Faleminderit kryesues.

Sa i perket këtij propozimi është e vërtetë se e kena pasur në email. Por ky propozim i dërgohet komitetit politik financa dhe kuvendit komunal, ne komitetin politik financa ju këto nuk e keni prurë si pikë të rendit të ditës as te të ndryshmet. Edhe sot, në fillim të seancës nuk e keni propozu për rend të ditës, kështu që ne nuk mundemi me shqyrtu këtë kërkesë. Këtë e lajm per seancen tjeter

Hajdar Sutaj

Kjo eshte ne kuader te pikes te te ndryshmeve

Vatan Istrefaj

po bohet matematik e keqe... nuk e ke propozu për te të ndryshmet

Hajdar Sutaj

Jam duke e propozuar tash në email e keni pasë, poashtu poashtu n'komitetin për politikë dhe financa, të domosdoshme, por me kalu janë ato të cilat kanë implikime financiare, Leotrim Hadergjonaj e ka fjalën.

Leotrim Haderxhonaj

Pershendetje Drejtor

Unë i kam disa pikëpyetje per këtë pikë të rendit të ditës besoj se meritojm nje.... Po tash nëse diskutohet ni përgjigje konkrete ku është kjo ndërtesë, ne cilin llot, për cillin llot jom tu fol se ne imell nuk ka ardh kurgja kan ardh dy letra e para ku është kjo ndërtesë? E 2-ta me na tregu ma konkretisht apo lyp 900 metra katrorë me bo ndertim te ri ne ato hapsira a po eshte ndertim egzistus Nëse është ndërtim ekzistues -

Hajdar Sutaj

Jo më fal kolegë fillimisht a doni me diskutu si pikë të rendit të ditës te të ndryshmet Po të të ndryshmet është ka ardh propozim te të ndryshmet. Po te të ndryshmet kemë drejtë me diskutu. Po e kam dërgue edhe materialin më falni unë jam duke e pyetur kuvendin ja u kemi dergu materialin ne email ka ardhë si propozim, kush është për me diskutu? Kush është për mu diskutu? me falni Arjan edhe ju.. jemi tu votu. Kush është për me diskutu këtë pik të rendit të ditës Falemnderit 10 vota, kush është për mos me diskutu. Falemnderit janë 8 vota kundër. Abstenim? Janë 2 vota. E diskutojmë, urdhëro Leotrim vazhdo

Leotrim Hadergjonaj

Drejtor me na tregu ma konkretisht 900 metra katrorë i paske pas me leje të vjetër që u marë vendimi në asamble tash po don me u bo 1.700 metra podrum, këto metra ajo të ndërtume ai padrum apo ka me u ndërto podrum i ri me na sqaru tjetra.. për me e ditë ne sakt a nevojitën qekaq metra katrorë për këtë objekt është mir me pas projektin ose me dit sa banesa me na cekë janë 80 banesa jan 30 banesa, 20 lokale me dit ato 1.700 metra katror që e keni cen kërkesë edhe skica ku është kjo hapësirë e ndërtume që po e don me e marr me ditë. A është... a bien ndesh me planin rregullues dhe me projektin që i ka pagu komuna 200.000 euro për me u ba projekti qendra e qytetit që është zgjedh nga komisioni me ditë kjo a bie ndesh me ato pika, ato rrugë, ato

projekte ku është? Është mir me i pas këto informata na paraprakisht përderisa nuk i kemi as mënyrë elektronike as të shënime për me ditë qfarë vendimi po marim faleminderit shumë.

Hajdar Sutaj

Falemnderit Leotrim fjalën e ka drejtori Ram Melaj.

Ramë Melaj

Leotrim, falemnderit për pyetjet.

Fillimisht do të hy ne një temë që është pak mu sqaru si fillim që është dasht të bëhet kjo punë ashtu siq duhet. Vendimi i datës, te gjej këtu 03.09.2015 që është marrë nga asambleja komunale në këtë vendim janë përzgjedh ofertat të cilat kanë ofertuar për me i marrë tokat komunale në shfrytëzim për 99vite. Ky vendim kur është hartuar nga asambleja nuk i ka konsultuar ligjet në fuqi që i ka ministria e ambientit, cilat janë ato ligje? Ligji i ndërtimit numër 04 e 110 ligjit planifikim hapësinor 04 e 174 udhëzimet administrative 08-2017 rregullore për normat teknike të cilat janë, është me numër 03-2016 edhe plus plani rregullues qendra, edhe detaje tjera. Do të thotë në vendimin kur është marrë në atë kohë më datën. 03.09 2015 janë caktu hapësitrat të cilat ka për të ndërtuar kompania. Do të thotë, në keto hapësira për ndërtime nëntokësor se dallojnë ndërtimet mbi tokësor nëntokësore, dallimi ...ndërtimi nëntokësore janë parapa aq sa është shputat në atë kohë vendim që dimensionet e shputës që janë dhanë në atë kohë nuk ka mundur me plotësu kriterin i cili ka të bëjë me rregulloren e ministris së mjedisit planifikimit hapësinor për normat teknike për ndërtesat, të cilat janë me bashkëpronësi, ku për çdo njësi banimi kërkohet të jet një parking në atë sipërfaqe që është dhën nga asambleja, nuk ka mundësi të ndërtohen ato parkingje, kështu që drejtorja e Urbanizmit tu bazuar në ligje dhe norma i ka respektuar ato dhe ka dhënë sipërfaqen më tepër për me mujt me mbërri, sipas normave që i parasheh ligji do të thotë është shtuar dikun për 900 metra katror podrum për të plotësuar kushtet që i kërkon udhëzimi administrativ. Do me thanë tash tu u thirr në ata që vendimi që është marr në atë kohë nuk ka pas mundësi të realizohen, të nxirren këto do të thotë nuk është harmonizuar vendimi i asaj kohe me ligjet që kanë qenë fuqi, për këtë arsye kërkohet që të bëhet rivlerisim ndryshim i këtij vendimi, që të jetë vendimi në harmoni me ligjet të cilat janë fuqi. Objekti është i ndërtuar nuk pengon, leja është lëshuar me këto parkingje të cilat bashkë udhëzime administrative. Nuk i pengon projektin e qendrës që thatë më herët do me than nuk ka të bëj me qendrën osht loti 4 i ndërtimit, kjo ka të bëjë me llotin lika 3 që e ka përballë gjykatës.

Hajdar Sutaj

Drejtor falemnderit dikush tjetër prej diskutuesve Hyrije Dobrunaj e ka fjalën, mundësisht po drejtor... Kështu e kom ni kërkesë edhe për ty dhe për Leotrimin. Meqenëse jeni duke diskutuar krejt çka keni edhe Leotrimi mund të drejtohet.. edhe masanej tu japim hapësir në rregull Ram Melaj e ka fjalën

Ramë Melaj

Leja që është lëshuar është bazuar në te gjitha ligjet e shtetit që cilat janë. Do me thanë këtu është bërë mos harmonizimi vendimit të asamblesë me ligje të cilat duhet të zbatohen nga urbanizmi.

Hajdar Sutaj

Falenderit shumë drejtor, a pate diqka te pa qart Leotrim thashë mos ki naj pyetje shtesë. Hyrije Dobrunaj e ka fjalën.

Hyri Dobrunaj

Dhe në kundërshtim me vetveten se përnime, kjo nuk është dashtë të diskutohet sod, por është dashtë me pasë kohë me diskutue është dashtë me ardhë ne kpf , pastaj me ardh këtu po prap se prap e ndëgjova drejtorin. Kjo temë është prej vitit 2015 un saktësisht nuk po e di për cilën ndërtesë bëhet fjalë. Mirëpo, nëse flasim për ligjet që janë në fuqi, edhe komisioni i 1-rë kur është themeluar, atëherë për këto çështje, për dhënien e pronave me koncesion afatgjatë do të thot e mbaj mend shumë mirë që komisioni i ka shqyrtu të gjitha ligjet mirëpo komuna asnjë nuk e ka qar deri ne fund. Po e them vetëm një detaj 30 për qind, atëherë ka parapa ligji secili objekt 30 për qind është dashtë me pas zona të gjelbërt, asnjë nuk e ka komuna ka leju ashtu me u ndërtu pa standarde pa ligjë pa kriter pa kurgjo nese flasim per 21% të cilin komuna atëherë e ka dhënë si shifër per me mar 21% të vlerës së përgjithshme të objektit është dashtë me ju dhanë komunës si kompensim. Kurrë edhe në atë kohë si asambleiste edhe sot kom bo pyetje vazhdimisht kurrë nuk e di dikush i ka marrë ku janë çka jonë nuk e di a i keni marrë banesa shitore, a çka është se asnjëherë nuk janë pasqyruar raportet financiar. Në qoftë se komuna i ka marrë dhe është dashtë me i marrë sipas ligjit nuk janë pasqyruar asnjëherë raportin financiar, kështu që sinqerisht kjo temë ka dashtë kohë ma shumë jo me pru ju këtu dhe marr më thonë duheni, sepse nuk e keni harmonizuar. Po ju vetë atëherë kështu e keni pa ju ka konvenu tashmë po ju konvenon ndryshe, me ja dhan dikujt dhe 1 pjesë për podrum. Kjo është shumë e dëmshme, kjo është e panershme, edhe mos e bëni se nuk ish dashtë me bo te pakten pak kohë me na dhon edhe me ..me.., bo ndryshe se kështu është shumë sipërfaqësore.

Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë, prej Vetëvendosjes Faton Selmanaj.

Faton Selmanaj

Faleminderit kryesues.

The se na ka ardhur në email ky dokument po mendoj që është dashtë me ardh me kohë po ashtu është dashtë edhe ne komision te financave me u trajtu. Sa i përket kësaj çështje po u bëjka fjalë për parkingje me sa kuptova. Drejtor e dimë se si keni funksionuar dhe qa keni vepru si drejtori kështu vazhdimësie ndër vite një problematike e ngjashme ka qenë edhe me 2 objektet që janë përballë komunës. Nuk po e di saktësisht sa vite jonë, po mund të jenë rreth 10 vite ku e keni zhvendos parkingun e komunës për arsye që është dashtë me e plotsu një kriter e keni fut ma brenda me arsyetimin që po doni me leju lëvizjen e lirë të zyrtarëve komunal dhe e keni hap disa parkingje para komunës. Kështu që po shihet ashiqare se në vazhdimësi jeni duke vepruar si me thonë ..tu pa tu bo, dhe ne si grup jemi kundër përkrahjes së kësaj kërkesë.

Hajdar Sutaj

Falemnderit shum, tjetërkush a ka diqka Miftar Ahmetgjekaj

Miftar Ahmetxhekaj

Faleminderit shumë.

Drejtor e para materialin tashmë e pranova, ka problem disa...disa nuk e kemi marr ket material unë sod e pashë. Megjithatë vendimi u mar me 03.09.2015 drejtor apo? Dhe që ky vendim nuk është kompatibil me nje normë apo me rregulloren 0 3, 2016. Kështu ja keni bashkangjitur unë se di, mendoj që e njoh pak a shumë fushën e legjilacionit, unë se di pse ish dashtë vendimin i 2015 të parasheh se si ka me qenë normal ne 2016-të shumë gabim..nëse ti në vitin 2015 ke marrë një vendim ti ki pas 1 rregullore 2010 pse duhet në mënyrë retroaktive? Pse duhet me parapa? Po kjo

është paragjykim. Rregulloren cilin ju po i referoheni është viti 2016 sinqerisht nuk po ju kuptoj, nëse ju e keni bo me normat 2010 jemi ne rregull, pse duhet thjesht ... ti nuk ke detyrim ndaj rregullores 2016, nëse ti vendimet i ke marr në vitin 2015 ose tash nuk po du me paragjyku do me shfrytëzu rregulloren 2016 për shkak me përshtat një diçka që s'po paragjykoj më shumë

Hajdar Sutaj

Faleminderit Miftar fjalën e ka Drejtori Ram Melaj.

Ramë Melaj

Faleminderit per pytjet te gjith qe i bët ... kështu është problemi. Drejtorja e urbanizmit punon me ligje të cilat janë ekzistuese në fuqi jashtë ligjit as nje pun nuk e marrim. Ndërsa për parkingje, sepse kjo fjalë është te Hyrija ..na sipas ligjit punojmë. Ani pse do të thotë ligjet i kemi tash funksionimi dhe përfundimi objekt çështje tjetër, por leja lëshohet sipas ligjit, të cilët i kemi në fuqi. Ndërsa për parkingjet që janë bërë përball komunës edhe aty është një marrëveshje e ka bërë asambleja dhe komuna për me i shfrytëzuar hapësirat për me liru qasjen për hy ne komun osht ni marrëveshje është kry nuk e di ne 2011-2012 nuk ke di kur ka qen ajo.. me marrveshje është bër. Ndërsa sa i përket plotësim ndryshimit këtij vendimi Miftar ne po deshirojm ta plotsojm dhe ndryshojm me akte ligjor të cilat i kemi tash, jo me akte ligjore që kanë qenë më përpara, por akte ligjore qe i kemi tashmë në funksion edhe me ligjin e ndërtimit, sepse thuhet te ligji i ndërtimit çdo njësi banimi duhet te ketë një 1 parking nen sipërfaqen të cilën e kemi lëshuar lejen e sipas vendimit të asamblesë nuk ke mujt me i siguru gjitha parkingjet e nevojshme për banorët të cilët janë aty dhe kemi respektu ligjin e ndërtimit, normat e ndërtimit dhe në bazë tyre është leshuar edhe leja Kështu që po kërkohet të harmonizohen këto gjana me ligjin e ndërtimit me normat teknike dhe ta kemi një plotësim ndryshimi të këtij vendimi që është marrë me 03.09.2015. Nuk mundemi na me plotsu me ndryshu funksionet e ekzistuese tani për tani.

Hajdar Sutaj

Faleminderit drejtor për sqarimet në emer të grupit të AAK-së Leotrim Hadergjonaj apo don Hyrije me fol ..Hyrije Dobrunaj ju ka permendur emir dhe pastaj Leotrimi ne emer të AAK-së

Hyri Dobrunaj

Po shumë e vërtetë, shumë e saktë ajo çka e the leja jepet si mbas ligjit ashtu edhe është bërë aty se konteston as e kundërshton askush. Mirëpo çka ndodh nëse nuk plotësohen kushtet ligjore dhe nuk respektohet ligji i ndërtimit asnihere që në Deçan ka ndodhur unë thashë që ka ndodhe dhe ti dhash shembujt, çka ndodh atëherë kush është fajtor se na duhet me dit. Po shumë e vërtetë leja është dhën sipas ligjit Por kur nuk respektohet as njona as tjetra çka ndodh kush eshte fajtor.

Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë Leotrim Hadergjonaj e ka fjalën.

Leotrim Hadergjonaj

Drejtor me aq sa kuptova veq nje sqarim u dasht me na ba pak mat kuptushum per ne nuk kishe pas telashe ne këtë tem, vendim i asamblesë për llotin 4.9.2015. Vendimi kur u marrë leja se ajo ka vanuar procedurat deri sa është ardhë për leje ka aplikuar ai që ka fituar llotin u marrë 2016 e meqenëse 2016 ti e ke marrë me vendim me ligj të ri, me ligj të ri ti ja ke jep metrat katror qysh e thot ligji i ri i 2016-ës e ti tashti po na kërkon ne me votu në bazë ligjit të ri dhe në rregull jam.. se ti kur ia ke jap leje ndërtimore, e ke japë në bazë të ligjit të ri në fuqi që ka ndru ligji Po

domethonë me rregulla të reja cilat kanë hy në fuqi me ligjin e 2016-ës, e Miftar ktu kur u marrë.. Ta përmend emrin bojm replikë se e kam për mirë besoj... vendimi kur u marrë atëherë për me jap llotin 4 ka qenë 2015-ës për këto metra katrorë, atëherë ka qenë ligji i 2010, por momentin derisa ka ardhur procedura u zgjedhur ofertusi, u nënshkrua kontrata ka aplikuar për leje ndërtimore momentin kur ai ka aplikuar për leje ndërtimore ka aplikuar me ligjin e ri tjetër në fuqi që është i 2016-ës ..e leja po thot këtu është marrë muajin e 9-të 2016. Edhe atëherë u respektu ligji i ri fuqi, jo i vjetri me ligj të ri i kanë taku 1.700 metra katrorë podrum nëntokësor për shkak sipërfaqeve të banesaev të bodrumit drejtori kështu me na pas spjegju e ka pasë në rregull. Tash e kom të kjart për mua është e kjartë është është në baza të ligjeve ekzistuese në fuqi.

Hajdar Sutaj

Faleminderit Leotrim. Miftar Ahmetxhekaj ju ka përmend emri ka drejt 1 minutë.

Miftar Ahmetxhekaj

Faleminderit edhe drejtori ma ka përmend emrin koleg i nderuar. Këtu flasim për rregullore, jo për ligj. Ligji është i njëjtë, ligji është i pandryshueshëm. Ligjin e keni referenca ligjore është 04134 për ndërtesat e banimit drejtor, ndërsa rregulloret janë...ju kur e keni marrë vendimin e keni pasurë rregulloren 2014 në fuqi. Këtu është... dëmthën , këtu e kam unë dilemën, pse duhet mi referuar 2016 kur ti ke marrë vendim, nuk ka rëndësi kur u lëshua leja, kjo i bjen kjo bjen sikur planet zhvillimore komunale. Nëse eventualisht shkon e merr e ti... Aplikoni një plan P. plus 4 në qendër Deçanit mas 5 vjet e bën P plus 7 ..hajde tash tjav hjekum kulmat tjav rrisim katet Referencën.. nëse ti nuk ke qenë në harmoni me ligjin është temë tjetër. Nëse i referohem rregullores viti 2016 për mendim timin je gabim. Ose thjesht je ka don me ja përshtat dikujt që...nuk edi.

Hajdar Sutaj

Faleminderit Drejtor a ke diqka për të shtuar ...Drejtori Ram Melaj e ka fjalën.

Ramë Melaj

Miftar pikë së pari nuk po dojmë me ja përshtat askujtë..ta përmenda prap emrin kerkoj falje se prap e kerkon fjalën do të thot nuk jemi duke ja përshtatur dikujt Është e vërtetë se 2015 është marrë vendim nga asambleja. Nuk ka aplikuar, edhe pse e ka marrë pronën më vonë ka aplikuar për leje ndërtimi e tash ne.. nuk jemi duke ja përshtatur askujt se është objekti i perfunduar Veç po dojm me i harmonizu ligjet me vendimin kurgjo ma teper Gjithmonë duke pas parasysh edhe vendimet e juaja që dalin nga asambleja komunale është mirë të hin në një filtër që quhet zyrtari ligjor. Që mos me u marrë urbanizmi me ligjet, që si përgjithësi është e asamblesë, ne e marrim si të gatshme apo si të mirëqen një vendim që vjen nga ana e juv edhe jemi të obliguar me zbatu atë vendim që merrni ju.

Hajdar Sutaj

Faleminderit shum. Miftar po urdhëro.

Miftar Ahmetxhekaj

Por norma, e cila përcakton parkingun, a është brenda dispozitave ligjore të ligjit 04134 lema rregulloren anash..nëse është brenda këtyre kornizave nëse është brenda dispozitav të ligjit, ligji ka fuqi mandatus më shumë sesa në rregullore. Kaq e kamë.

Hajdar Sutaj

Po faleminderit shumë Drejtori e ka fjalën. Edhe pastaj Moni ka kërkuar fjalën ...pasataj Fatoni e

ka kerkuar fjalën pastaj edhe 5 veta të tjerë janë lajmruar për fjalë. Drejtor urdhëro

Ramë Melaj

I nderuar Miftar. Çdo udhëzim administrativ dhe çdo rregullore rrjedhin nga ligji. Jashtë ligjit smunden ato me u ba Bazuar në ligjet dhe rregulloret dhe ne jemi ata që duhet ti zbatojm tek rregullorja po e marrë si shembull. te rregullorja 08 2017. a e din se qfar thuhet aty Ndërtimet nëntoksore ka mundësi të shkojn deri në 80% të sipërfaqes së parcelës. që asnjëher ne komunën e Deqanit nuk është zbatuar kjo rregullore në rastin konkret. janë shfrytëzuar vetëm 34 për qind të parcelës për ndërtimin nëntokësor do me thanë komplet jemi brenda kornizave të udhëzimit dhe të rregulloreve që dalin nga ligji për ligjin e ndërtimit.

Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë drejtor kolegë. Mendoj që është e shtjerrum debatin ..koleg a ke diqka tjetër a me ta jep fjalën se ke than qe ski qka me thanë në rregull zotri Mon Selmanaj udhëroni

Mon Selmanaj

Faleminderit Drejtor ju that që Objekti është i ndërtum. Dhe janë, të parapame 800... jo në fakt është i ndërtuar edhe parkingu nëntokësor prej 877 metrav katror Ju po kërkoni që. Të bëhet ndryshimi në 1.737 metra katror atëher këto përafërsisht 900 metra katror. Ku do i merrni? Dhe është 1 diferencë e madhe që objekti është i ndërtum tash si po don me i legalizu ti këto apo me e ndryshu a jon ndërtuar apo janë rreth objektit të zhvillohen sipërfaqe apo posi qëndron kjo se kom paqart qet pjesë faleminderit.

Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë drejtor a ke diqka me shtu a jo? Drejtori Ram Melaj e ka fjalën edhe po e përmbyllim si pik.

Ramë Melaj

Mon a bon? Kështu Mon Objekti është i ndërtuar krejt sipas lejes së ndërtimit që ka lëshuar drejtorja e urbanizmit, drejtorja e urbanizmit. I ka zbatu ligjin fuqi në bazë ligjit ne kemi vepruar. Për shkak se nëse nuk i kishim realizuar ata, se si e thotë ligji, padyshim qe ne kishim bër shkelje, sepse skemi kriju vend parkingje të mjaftueshme për banorët të cilët janë në atë objekt do të thotë vendimi kur është marrë në atë kohë nuk është konsultu me ligje të cilat janë fuqi. është dhën aq sa është shputa u zbatu plani rregullues me gjitha vijat e ndërtimit dhe kushtet gjithë këto, ka të bëj vetëm me ndërtimin nëntokësor, i cili është i realizum. Nuk kem nevojë me e damtu ndonjë teren dikund, ndonjë sipërfaqe që kish pasë bo dom rrethit, por është objekti i ndërtuar sipas leje vetëm të harmonizohet me ligjin fuqi, të cilat i ka shteti jonë për ndërtim. nuk ka ndonjë diqka që ka ndonjë implikim apo ni telashe të më vonshme

Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë Drejtor e qes në votim kush është për? Faleminderit a ka kundër? A ka abstenim? 1 abstenim 8 vota kundër 10 vota për, e kemi miratuar propozim vendimin e kryetarit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit të kuvendit të dates 03.09.2015 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës komunale, lloti numër 4. Koleg 2 njoftime krejt të shkurta. E para e dini që më rregullore të punës e kemi gushtin pushim. Dhe nuk është obligim do të thotë që ne me marrë vendim për pushim është me rregullore të punës Edhe e 2-ta m'kanë kërku që me bë publike këtë kërkesë Apel për ndihmë. Për Erion Zeqiraj 3 vjeçar nga Busha ..mundësisht kushdo

që mundet prej juve, por edhe të tjerë që munda me diskutu me ndihmu shërimin e tij prej 25.000 euro në spitalin e shkupit dhe është publike xhirologaria e familjes së tij? A pat dikush diçka me shtu te të ndryshme ndonjë pyetje? Miftar Ahmetxhekaj e ka fjalën pasë Faton Selmanaj Fatoni e ka fjalën pastaj ti

Faton Selmanaj

Faleminderit për fjalën kryesues. Gjatë muajit e kam pasur 1 vizitë në ndërmarrjen regjionale hidrodrini. Si komision komunal ku kemi diskutuar për ujë të pijes Pyetja e parë është për ty kryesuese aty jemi dakordu që me i bashkërenduar veprimet bashkë me inspektoratin komunal, po drejtori i inspeksionit shihet që s'ka kurrfarë respekti për kuvendin dhe nuk është prezent këtu Pyetja e 1-rë është për ty se a ju ke kërku në emër të kuvendit dhe komisionit. Drejtorisë së inspeksionit. Më ndihmu ndërmarrjen në këtë aspekt, sepse e dini që. Nuk jemi duke pasur ujë të pijes Në veçanti ato 10 fshatrat. Pyetja e 2-të është për drejtorin e bujqësisë ku dua të japë një kompliment drejtor pavarisht obligimit që e ki të falenderoj për rrespektin që po ja bën kuvendit dhe nuk e di ne ndonjë seanc që ke mungu e që nuk ke qendruar deri në fund Pyetja është që..po ashtu natë e ditë..kemi qenë edhe në ndërmarrjen Drini i Bardhë pavarisht që nuk ka qenë kompetenc e jona, nuk është që kemi marr ndonjë besim prej kuvendit për me kontakti edhe ata ndërmarrje me diskutu. Po ka qenë kërkesë e kryesuesit që ta vizitojmë dhe na kanë pritë shumë mirë menaxhmenti i ri kemi parë që ata kanë fillu me i bo disa punime, por përgjatë muajit personalisht kom pas disa ankesa prej qytetarëve, në veçanti në pjesën e Carrabregut ku nje banor i asaj zone kishte bllokuar dhe kishte betonuar një kanal të ujitjes Po ashtu, kryesuesi është zotu se kom e diskutu me inspeksionin.. komunal dhe kanë me i bashkërenduar veprimet në situata të tilla dhe kudo që është nevoja. dashta me të pyet se është liruar aj kanal i ujitjes dhe nëse mundesh pak me gjërsisht me na tregu situatën. lidhur me ujin e ujitjes brenda. komunës. Pyetje tjetër e kom pasë per drejtorin e shërbimeve publike i cili nuk është këtu Pyetje tjetër kam pasur për drejtoreshën. shëndetësisë, e cila po ashtu nuk është këtu. Po sido që të jetë, unë pyetjet po i parashtrij pyetje për drejtorin shërbimeve publike është që është një pyetje edhe me e hershme që e kam bërë... lidhur me rrugët regjionale dhe lokale dhe.. për pastrimin e tyre ka deklaruar se kontrata për pastrimin e tyre osht aktive po nuk kam parë që ka pas ndonjë reagim në teren Pyetje tjetër. kam pasur për drejtoreshën e shëndetësisë. Lidhur me kujdestarinë e barnatorëve e dimë që tash jemi në 1 situatë krejt tjetër, përderisa kanë ardh shumë bashkatdhetarë. Shumë mirë që kanë ardhur. Dhe mendoj që të paktën është dashur me nxerr një udhëzim apo një vendim si drejtori që në këtë periudhë kohore, të paktën 2 javore me pasë barnatore të hapura më shumë, e në veçanti, në pjesën ka regjioni i shtëpis së shëndetit, Faleminderit.

Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë kështu meqënëse rregullorja, thotë se në munges te kryesuesit. seancën e vazhdon asamblisti më i vjetër ftojë Mon Selmanaj për shkak që kamë një obligim dhe më duhet me dalë Po i kom bisedu me ta dhe u mbet me i bashkërenduar aktivitetin me njësinë Deçan dhe kanë qenë një ditë ispektoriati këtu .. a mundesh me ardh me vazhdu seancën ka shumë te lajmëruar po ja kaloj fjalën drejtorit deri sa te vjen Moni. Drejtori e ka fjalën

Drejtori

Faton faleminderit per pyetjen dhe për shqetësimin e ngritur prej banorët të asaj zone dhe prej stafit të menaxhues Drinit bardhë jam njoftue se ajo e bllokada që ka qenë atje poshtë ku e potencova është bllokuar dhe banorët e asaj pjese kanë ujit pronat e tyre, pronat e tyre bujqësore. Kështu s'paku jamë njoftu ne jave ne javën e kalume. Sa i përket te menaxhimit te

Drinit bardhë. është një temë që një herë e përgjithmon kish qenë mirë mu sqaru pak ma detajisht ne gjithë jemi persona që e bartim kompetenc dhe përgjegjësi edhe publike edhe kishin qenë mire qe ne ato zona ku e kemi ndikimin tonë, ku çdo ditë takojmë banorët kishin qenë mirë me tregu kompetencë e kujt është ujitja dhe kompetence e kujtë është ujt te pijes. Ne si komunë nuk menaxhojmë, as me ujë të pijes as me ujë të ujitjes për çdo ditë në ato kapacitetet tona, në ato mundësitë tona tentojm që me ju bërë zgjidhje banorëve. Fatmirësisht ka ardhur ni staf i ri menaxhues në krye te Drinit bardhë, i keni vizituar dhe ju jeni taku me ta e për nesër n'ora 10 e kemi lënë një takim për me ardhur ata në komunën e Deçanit mu taku bashkë edhe me i pa modalitetet dhe format qysh kemi me ja ba në të ardhmen cilat kan me qenë format e bashkëpunimit. Komuna e Deçanit gjithmonë ka qenë e hapur me i ndihmu fermerët me i përkrah fermerët, por njëkohësisht me i ndihmu dhe me bashkëpunu me institucione të tjera si në këtë rast që është Drini i Bardhë. 2 vite më herët kemi bashkëpunu me takim pas 2 marrëveshje me ta i kemi përfunduar ato 2 marrëveshje poçe. qe një vitë e gjysë përafërsisht 2 vite ajo kompani ka qenë pak a shumë edhe inekzistente, as nuk ka pas bord të mirfillt komuna e deçanit si një hisedare e madhe e as nuk ka pas menaxher për Deqan as nuk ka pasë punëtorë e javën e kalume e ka nxerr ni konkurs që kanë kërku me i punsu 2 inkasanta më duket me datën 29. ka përfunduar konkursi, kanë apliku 3 veta kënd e marrin në punë kënd nuk e marrin nuk është qështje e jemja dashtë zoti që njëherë e përgjithmonë ajo kompani mu ngrit dhe me me vazhdu me punë. Na si institucion, gjithmonë kemi qenë aty në ato mundësitë tona që i kemi Faleminderit per pyetje.

Faton Selmanaj

Drejtori Rifat unë i kuptoj kompetencat dhe përgjegjësitë dhe të komunës dhe të ndërmarrjes, por për derisa një qytetar e ka bërë një ndërtim aty. As ndërmarrja nuk ka drejt pa një urdhërese të inspeksionit komunal, me rrënu atë objekt apo ndërtim? Dhe mbi të gjitha siç e potencova edhe në fillim. kryesusi a me të drejtë a pa të drejtë ta japi një zotim para tyne që inspeksioni komunal kanë me qenë të gatshëm. Dhe kanë me i bashkërenduar veprimet nëse ka jep gabimisht, atëherë ju mundeni me kundërshtu dhe me demantu që ska drejt kryesusi me bo atë ndërhyrje kaq faleminderit

Drejtori

Kërkoj falje ..kërkoj falje. Nuk munda të jap përgjigje as për drejtorin e inspeksionit, as qfarë ka thënë kryesuesi japi përgjigje vetëm për ato përgjegjësitë me të cilat obligona si drejtor bujqësi.

Miftar Ahmetxhekaj

Faleminderit Po faleminderit kyresus i nderuar të uroj për punën dhe pse shkurt. Drejtor kështu realisht i kam pasur 5 pyetje drejtoresha e financës me gjasë i ka shpëtu njanës lidhur me bursat domethan është veprim i mir ..drejtor një pyetje e kamë realisht qe lidhen me infrastrukturën ka të bëj me 2 rrethrotullimet në fshatin Isniq. Unë e di se pengesat që janë vendos nashta nuk janë shumë funksionale, por megjithatë mund të jen një preventiv për aksidente. Ju siç e dini para disa dite te rruga e Vokshit ka ndodhur 1 aksident. kogja i tmerrshëm që ka mundur të jetë me pasoja fatale Për shkak se. Thjesht. Ndoshta edhe dukshmëria është e tillë që nuk po paraqet se aty ka rreth dhe nëse sheh si të arsyeshme vendosjen e pengesave qe të ketë masa preventive për aksidentet në të ardhmen. E për drejtorin me gjasë mund të jetë drejtori i ri. Faleminderit shumë kryesues. Me gjasë po i drejtohem drejtorit Rifat ka të bëjë me kompensimin e dëmeve, të cilat ju kanë shkaktuar fermerëve vitin e kaluar. është kërkesa e tyre të jemi të sigurtë absolut as për me marr poena ka fermerë thonë fshatin Isniq, i cili ka pasur 3 sera e erat ja kanë dëmtuar Vlerat

dikund 5.000-6.000 euro kushtet ekonomike janë bukur të cekta që ai me investu vetë dhe kështu që si pyetje a ka gjasa se kur pritet të kompenzohet këta fermerë? Ku është problemi i vonesës? Nëse mundem.. nuk du me paragjyku? A ka pas probleme në raport vlerësimeve domethonë nëse mundesh një përkufizim të shkurtë Drejtor, megjithëse nuk është kryetari këtu kryesues a mundem edhe një pyetje të shkurt, ndoshta nuk është shumë e gjat Lidhur me kontratën e fundit, unë e di që financues është ministria e infrastrukturës që ka të bëjë me segmentin ...strells Nëse nuk gaboju vlera e kontratës është 7,8 milion euro. Në media ka qarkulluar që kontraktuesi i 1-rë, unë se jam i prirë të flasë me emra Edhe pse dallueshmëria ka qenë afër 640.000 euro. Tenderin e ka fituar ofertuesi më i shtrenjtë nëse mundeni një Përshkrim ose 1 arsyetim. Nëse keni kompetencë me fol për këtë. E. Vlera për 1 kilometër nëse e përkthejmë në kilometër i bjen 2.2 nëse nuk gaboju. 2,2 milionë për 1 kilometër autostrada Ibrahim Rugova kam informat të saktë e kuptoj ndryshimin e çmimeve. Vlera për 1 kilometër ka qenë 1,2. Nëse mundni këto çmime për shkak se procedurat e prokurimit i ka zhvilluar komuna Faleminderit shumë keto ishin pyetjet faleminderit kryesues

Mon Selmanaj

Faleminderit Ahmetxhekaj pak ke qenë i gjatë po. Por e respektoj atëher Drejtor për juve është fjala Për drejtorin një herë, pastaj për ju.

Drejtori

Miftar pyetje ...pyetje shumë me vendë edhe ni përgjigje që duhet besoj që duna me ta dhanë një përgjigje pak ma plotësuse Deri vitin e kalum komunat kanë pasur të drejt secila drejtori me pas nga një komision të vetin. E sidomos bujqësia ka pas punë kët far teme se pothuajse çdo vit fermerët dëmtohen në forma të ndryshme. E prej vitit kaluar nuk ka ma komisione të drejtorive, ka komision komunal, që është i përbën prej gjitha resurset të komunës dhe nuk ka komisione te ministrive po ka komision qeveritar. E arsyeja pse disa fermerë në raportimin e 1-rë kanë mbet pa u përfshi nuk është faji i komunës. 1 email që është dashtë me shku komuna nuk ju ka shku gjitha komunave në kohën reale. Gjitha ata fermerë ose pronarët e shtëpiav ose pasuni ose bizneset që janë dëmtu shtatorë e tutje, por edhe komuna e Deçanit e ka themelu komisionin, zyra kryetarit të gjithë ata janë përfshirë këtë informacion kam unë. Ata fermerë që janë dëmtu në shtator... para shtatorit nuk kanë qenë të përfshim. Mirëpo çka ..çka kemë me bo na .. se une per kete teme jam njoftue prej banorëve dhe fermerëve. Po të njëjtën pyetje pata edhe prej kolegut juve prej Syl Balaj edhe Syles ja japa këtë përgjigje na jemi përfitues të atij projekti që patëm sjellë para 3 muajve që është me me ndërtimin e 55 serave , e po besoj që deri më 15 gusht edhe e nënshkruajmë kontratën me donatorin 1 prej kritereve që kam me qenë lehtësuse e ka me qenë që fermerët. Të cilët janë dëmtu kan me pasur përparësi si përfitimin e 1 sere kaq mund të bëjë komuna se kur do ti marrin parat, por se kur do kompensohen fermerët e dëmtuar në shtator e tutje nuk e dime me ta dhënë këtë përgjigje. E di që është 1 raport që është ka punohet qeveri, por nuk mund te jap përgjigje.

Mon Selmanaj

Faleminderit drejtor.. drejtor Melaj drejtor Melaj e ka fjalën.

Ramë Melaj

Miftar.. Sa u përket. Sigurisë, në rrugën kryesore Deçan Pejë i kemi 2 rrethe ..rrethi te Ahmet Gjekaj dhe rrethi ne hyrje tash te trajtimi te kësaj rruge E kemi planifiku me i bo këto 2 pengesa

se kemi pasur edhe për qëllime gjatë punëve të tjera. po u kry qysh u kry dhe mbeten pa përfunduar e kem planë do të bohen ato Sa i përket tenderit, unë nuk merrem me tendera. mirpo mundem me dhan një sqarim lidhur me projektin. projekti nuk ka të bëjë vetëm për rrugën Bush-Strells, por ka edhe për rrugët anësore, sepse aty krijohen shumë probleme në qasje lagje të ndryshme të cilat kanë rikuperuar aty ka prej Isniqit deri ne Strells anën e djathtë ka te shkojsh për Pejë muri betoni pa shkeputje fare për shkak se niveli i tokës është asi soji që duhet me ju përshtat. Edhe kemi. Instalime nëntokësore gypa të ndryshëm, të cilët kanë ujit për infrastrukturë, telekomunikacioneve dhe elektrikes. Këtu, sipas mendimit timë e ka ngritur koston. se e ka marrë ma i lir ma ishtrejt nuk jam kompetent, sepse prokurimi keto gjera i ndjek me ligj. Sigurisht nuk kanë qenë përgjegjshëm të tjerët. Ka qenë i përgjegjshëm ky që e ka fitu edhe po me duket Lika.. me duket E fort mirë që ka marr Lika, sepse besojm kur te fillon nuk ndalet ani pse ndoshta buxheti do të vonohet? Nuk do të ndalet për me kry me dinamikat e parapame. Faleminderit.

Mon Selmanaj

Faleminderit drejtor, atëherë ju kisha lut që të jeni pakë më të shkurtër ne pyetje përgjigje urdhero Albesa ..Orgesi pastaj me radhë po shkojmë Albesë

Albesa Cacaj

Pyetja ime ka të bëjë ...kisha dashur të ishte kryetari për me ju drejtu, sepse 1 qytetar i komunës së Deçanit ma ka delegu këtë kërkesë që ta parashtrojë sot dhe të kërkojë përgjigje ka të bëjë me të drejtën për qasje ne dokumente publike. Konfirmimi edhe pse jam skeptike me këtë pyetje dhe e di që skam përgjigje po jam obligime me me delegu. në kuvend Komfort nenit 10 te ligjit për qasje në dokumentet publike, ku sipas paragrafit 1 te ketij neni shprehimisht thuhet se secili person ka të drejtë për qasje në dokumente publike. Në bazë të kërkesës me anë të kërkesës i nderuari ka kërkuar nga personi përgjegjës zyrtar në kuadër të zyrës së kryetarit. Të ketë çasje në 1 dokument e që ky dokument është marrëveshje ose kontrata e nënshkruar në vitin 2013 mes kompanisë austriake kelkos energy dhe Komunës E i nderuar çfarë ka dashtur ose arsyetimin që e ka bërë në këtë kërkesë ka kërku çë të ketë qasje për arsye që sa ka realizuar obligimet, ose sa e ka përbushë obligimet. Kompania kelkos qe ka pasur të nënshkruar me komunën, pra duke e cituar arsyen. Arsyja që unë si qytetar i kësaj komune po i kërkoj këta dokumenta publik është se unë çdo ditë kalojnë nëpër këtë rrugë. Ku janë ndërtuar këta 3 hidrocentrale? Dhe si pasojë e ndërtimit të tyre kjo rrugë është shkatërruar si pasojë e hidrocentraleve, ndërtimit të hidrocentraleve dhe jeta ime dhe e çdo qytetari i cili kalon nëpër këtë rrugë është e rrezikuar nga shembja e dheut e gurëve dhe urav. Ndaj si qytetar dua, kërkoj ti shoh ato kontrata që i ka nënshkruar kompania dhe ti shoh sa janë përbushur obligimet. po pikërisht këtë nen ceket në qoftë se komuna refuzon. Ose lejon refuzon.. ose lejon ne qastin atëherë i kthehet përgjigja me vendim, qytetari, nuk ka marrë 1 vendim të tillë, por është afati ligjor brenda afatit 5 ditor komuna. i kthen i kthen përgjigje dhe ky nuk ka marrë asnjë lloj përgjigje. Pse ndashta me ditë nuk ju ka leju qasja ose nuk ka pasur 1 informacion më të shtuar faleminderit.

Mon Selmanaj

Këtu përgjigjes nuk mundet me të jap askush nëse edhe ti Miftar nëse edhe ti Miftar kalon atëher, nuk kemi kurum për vazhdimin e seancës, kështu që po mbesin edhe 2 folës pa folë Orges. Veç edhe edhe Orgesi. Po atëherë Arjani ndoshta është tërhequr - shkurt shkurt Orges të lutem.

Orges Tafilaj

Pyetja është për drejtoreshën e financav në mbledhjen e fundit paraprahe kemi pasur raportin e auditorit për... auditorit jashtëm për ndërmarrjen higjiena e kemi parë që ndërmarrja funksionon mirë, megjithatë ka mungesë likuiditeti. Ne e kemi marrë 1 vendim që do i ndajmë 50.000 mijë euro për vendimin duk u bazuar vendimin paraprahe që t'ia paguajmë 0.85 centë qytetarëve. Ku jemi me pagesën dhe a është e mundshme të kryhet kjo pagese sa më shpejt, duke marrë parasysh mungesën e likuiditetit kompanisë faleminderit.

Mon Selmanaj

Faleminderit Orges urdhero drejtoreshë e do fjalën Dafina Ja kam dhënë fjalën Drejtoreshës njëhere

Dafina Cacaj

Po Orges vendimi që e kemi marrë për transfer të mjeteve nga kategoria mallrave në subvencione në emër të pagesës bazë vendimit për tarifen e qytetarëve që është 0.65 cent ne mi pagu e nuk kanë mujt me bo as nuk ka mujt me kalu. Për shkak se e kalonë përqindjen e lejuar me ligj që mundem me bo transfer. Unë momentin kur e kam bërë kërkesën drejtuar juve kam menduar që llogaritet përqindja në krejt subvencionet e ndara për atë vitë. Mirëpo ajo ish dashtë me u nda vetëm prej të hyrave të bartura, përqindja e të hyrave të bartura ..sa ke pasur në subvencione, unë realisht nuk kam pasur dhe nuk më ka lejuar kom kalu ma shumë se 15 përqind se qe eshte e lejume me bo transferin edhe vendimi u kthy në mujin e kalum negativ nuk kam mundur ta bëj pagesen Faleminderit drejtoreshë. Faton shkurt të lutem Faton shkurt të lutem.

Faton Selmanaj

Faleminderit kryesues kërkoj falje që më paska ikur si pyetje kështu. Drejtor nuk e di a je shumë kompetent me u përgjigj në këtë pyetje. Po bëhet fjalë për këtë kolektorin apo impiantin e ujërave të zeza në fshatin Drenoc ka pas me u vendos qe një vit edhe nëse mundesh shkurtimisht me na njoftu se qfarë ka ndodhë me atë proces, sepse më ka ra me lëvizë këto ditë në atë pjesë edhe kundërmon një erë e tmerrshme.

Mon Selmanaj

Atëherë me kaq faleminderit me kaq po e përfundojmë seancën e rregullt të kuvendit komunal. Shihemi seancat e radhës. Faleminderit në shtator shihemi.